

03-252 / 31

01.08.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS  
VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës  
Policijski Inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

*Raporti i Inspektimit Nr: 1 /2016*

**VLERËSIMI I MËNYRËS SË KRYRJËS SË  
DETYRAVE NGA ZYRTARËT POLICOR ME  
DATËN 28 NËNTOR 2015**



KORRIK 2016

*Ps:* HILMI MEHMETI

Kryeshef Ekzekutiv i IPK- së



## SHKURTESAT

---

PK	Policia e Kosovës
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DHK	Departamenti i Hetimit të Krimit
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
DI	Departamenti i Inspektimeve
DH	Departamenti i Hetimeve
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
DRP	Drejtoria Rajonale Policore
NJSO	Njësia Speciale Operative
NJSI	Njësia Speciale Intervenuese
NJRSH	Njësia për Reagim të Shpejt
UA	Udhëzimi Administrativ
UO	Urdhër Operativ
PO	Plan Operativ
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
DTK	Drejtoria e Teknikës Kriminalistike

# PËRMBAJTJA

---

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE.....	(4-5)
2. HYRJA.....	(6-7)
3. VLERËSIMI I ORGANIZIMIT/PLANIFIKIMIT, DHE MENAXHIMI I SITUATËS GJATË MANIFESTIMIT TË DATËS 28.11.2015.....	(8-19)
3.1 Veprimet planifikuese përgatitore policore.....	(8-13)
3.2 Veprimet policore operative gjatë protestës të zhvilluar me 28 nëntor 2015....	(13-17)
3.3 Veprimet policore pas manifestimit/protestës së 28 nëntorit 2015.....	(17-19)
4. VLERËSIMI I RESPEKTIMIT TË INFRASTRUKTURËS LIGJORE NË MENAXHIMIN E SITUATËS GJATË MANIFESTIMIT TË DATËS 28.11.2015....	(20-24)
5. VLERËSIMI I RESPEKTIMIT TË RREGULLAVE LIGJORE PËR PËRDORIMIN E FORCËS NGA ZYRTARËT POLICOR.....	(25-26)
6. PËRFUNDIMET.....	(27-28)
7. REKOMANDIMET.....	(29)
8. PLANI I VEPRIMIT TË PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK- së.....	(30-31)

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

---

1.1 Në bazë të nenit 24, paragrafi 2, të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), IPK-ja ka zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës (PK) lidhur me **“Vlerësimi i Mënyrës së Kryerjes së Detyrave nga Zyrtarët Policor me datën 28 nëntor 2015”**. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga zyrtarët policor gjatë protestës së zhvilluar me 28 nëntor 2015.

1.2. Inspektimit në këtë fushë i ka paraprirë, hartimi i programit inspektues. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren më datë 14.01.2016 deri me datë 02.02.2016, i cili është zhvilluar në bazë të planit të punës inspektuese i cili për objektiva ka pasur si synim të tij vlerësimin e organizmit/planifikimit dhe menaxhimit të situatës gjatë manifestimit/protestës të datës 28 nëntor 2015, respektimin e infrastrukturës ligjore, dhe respektimin e rregullave ligjore për përdorimin e forcës nga zyrtarët policor. Ndërsa fushëveprimi i inspektimit është shtri në burimet njerëzore, përmbajtja e shkresave siç janë urdhrat/planet operative, radio logu, përfillja ose referimi në infrastrukturën ligjore për të menaxhuar situatën, trajnimet për ndërhyrje në objekte të brendshme të njërive policore (NJSI, NJSO, NJRSH) si dhe respektimi i procedurave ligjore të përdorimit të forcës konform rregullave ligjore. Ky inspektim është përfunduar në korrik pasi janë përfunduar edhe shume veprime hetimore nga Departamenti i Hetimeve në IPK.

1.3. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës në këtë fushë është bërë për të siguruar llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në implementimin e ligjeve të aplikueshme, akteve nënligjore dhe procedurave tjera standarde të veprimit në fuqi si dhe për ngritjen e performancës së zyrtarëve policor në situatat e menaxhimit të turmave gjatë protestave të qytetarëve. Ndërsa inspektimi si metodologji pune ka paraparë intervistim të të gjitha strukturave policore të përfshira në menaxhimin e protestës, kontrollimin, shikimin dhe analizimin e të gjitha video-incizimeve, analizimi i infrastrukturës ligjore për fushat që janë lidhur me menaxhimin e situatës konkrete, si dhe kontrollimi dhe analizimi i gjithë dokumentacionit në të cilin është pasqyruar e tërë puna në menaxhimin e protestës. Po ashtu ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur.

1.4. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se PK megjithëse nuk kishte qenë e njoftuar konform Ligjit për Tubimet Publike për mbajtjen e protestës kishte arritur që me kohë t'i bëjë të gjitha përgatitjet dhe planifikimet e duhura për menaxhimin sa më të mirë situatës para, gjatë dhe pas zhvillimit të protestës. Pra, me kohë ishin hartuar Urdhri Operativ nga DPP, Plani Operativ nga DRP Prishtinë, Plani Operativ i Divizionit për Njësi të Specializuara.

1.5. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se manifestimi/protesta ishte zhvilluar e qetë, dhomat komanduese në DPP dhe DRP Prishtina ishin hapur sipas planifikimeve me fillim në ora 10:00, të cilat përmes zyrtarëve të caktuar kanë mbajtur shënime në radio-log ku janë paraqitur aktivitetet dhe ngjarjet e zhvilluara. Shënimet në radio-log tregojnë se manifestimi/protesta ka pasur rrjedhë të qetë dhe normale me ç'rast njësitet policore nuk kishin pasur nevojë për ndonjë intervenim. Duhet theksuar që disa nga komunikimet të cilat janë bërë përmes thirrjeve telefonike kanë rezultuar me mungesa të shënimeve në radio-log, gjë për të cilën është rekomanduar që në rrethana të tilla, PK të bëjë përpjekje maksimale që të aplikojë komunikimin me radio-lidhje përveç rasteve kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër.

1.6 Të gjeturat e inspektimit tregojnë se PK posedon infrastrukturë ligjore ku specifikohen detyrat dhe autorizimet e angazhimit të Njesisë Speciale Intervenuese e cila në rastin konkret sipas kriterëve të përcaktuara në U.A nr. 02/2012 Për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor dhe PSO me nr.referues NJSI/PSO/001/11 për NJSI, nuk ka pasur ndonjë kufizim ligjor për angazhimin e kësaj njësie. Është identifikuar që këto dy dokumente ligjore nuk kanë qenë të harmonizuara sa i përket autoritetit miratues për angazhim operacional të njësisë, ku është rekomanduar që këto dy dokumente të harmonizohen në mes vetë për të cilën çështje Policia e Kosovës ka treguar angazhimin e saj ku me datën 16.02.2016, është bërë plotësimi i UA nr. 02/2012, për Përdorimin Forcës nga Zyrtarët Policor. Po ashtu është rekomanduar që të bëhet përcaktimi i saktë i domethëniesve shprehimore për llojet e nivelit të rrezikshmërisë.

1.7 Me qëllim të një përgatitje të mirëfilltë të operacionit policor, PK ka hartuar Urdhrin Operativ në nivelin e DPP, Planet Operative në nivelin e DPP dhe DRP-Prishtinë të cilat gjatë hartimit janë bazuar në udhëzuesin për hartimin e urdhrave dhe planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policore. Inspektimi ka vënë në pah se disa nga shënimet në këto dokumente tek elementi pesë pikësh konkretisht tek Komunikimi dhe Administrimi ka pasur raste kur disa shënime nuk kanë qenë të plota ose shënimeve ju është ndërruar renditja. Kështu që rekomandimi ka potencuar që gjatë përpilimit të urdhrave/planeve operative të kihet parasysh respektimi në përpikëri i të gjitha pikave të parapara në udhëzuesin për hartimin e urdhrave/planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policore.

1.8. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se arrestimi i deputetit Albin Kurti nga NJSI është bërë në bazë të Urdhër Arrestit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë duke respektuar procedurën e paraparë në KPPK –së “Arsyet për kontroll pa urdhër të gjykatës”, konkretisht nenin 110, paragrafi 1, pika 1.5. Po ashtu, angazhimi NJSI është bërë nga udhëheqësit e dhomës komanduese në DPP gjithnjë duke pasur parasysh ngjarjen e krijuar, numrin e protestuesve që kishin bllokuar hyrjen në selinë e lëvizjes VV, informatën për një numër të konsiderueshëm të personave që kishin hy brenda objektit ku duhej të realizohej operacioni dhe mungesës së informacioneve për identitetin e këtyre personave si dhe trajnimet e të gjitha njësive policore. Po ashtu, inspektimi ka vënë në pah se si rezultat i realizimit të Urdhër Arrestit, zyrtarët policor kanë vërejtur gjësede të kundërligjshme të cilat departamenti i hetimeve i ka marrë si prova dhe i ka përcjell në procedura të mëtejme duke i dorëzuar raport prokurorisë kompetente, gjersa inspektimi ka treguar se raporti nuk është përcjell edhe te gjyqtari i procedurës paraprake, me ç’rast rekomandimi ka parashtruar si kërkesë që të kihet kujdes në kërkesat ligjore gjatë mbledhjes së provave në vend ngjarje.

1.9 Të gjeturat tregojnë se PK, për të realizuar Urdhër Arrestin e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ka hasur në rezistencë nga ana e disa personave me ç’rast nga policia është përdorur forca fizike, shufra e gomës, sprej OC dhe gjatë këtij operacioni janë lënduar pesë (5) zyrtarë policor. Ndërsa PK, ka arrestuar gjithsej 97 persona ndaj të cilëve janë përfill procedurat e mëtejme ligjore. Pas përfundimit të të gjithë operacionit, dhjetë (10) zyrtarë policor kanë plotësuar formularët për përdorimin e forcës, me ç’rast Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës Fizike pranë PK-së, ka marr vendim që forca e përdorur ka qenë në përputhshmëri me UA nr. 02/2012 për Përdorimin e Forcës Fizike nga Zyrtarët Policor.

1.10. Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 30.06.2016, ka mbajtur edhe takimin përmbyllës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport.

## 2. HYRJE

---

2.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të jashtëzakonshëm nga data 14.01.2016 deri me 02.02.2016, në Policinë e Kosovës, me temën “Vlerësimi i mënyrës së kryerjes së detyrave nga zyrtarët policor me datë 28.11.2015 në Prishtinë”.

2.2 Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi të jashtëzakonshëm ka qenë të evidentojë, analizojë dhe vlerësojë performancën e strukturave policore të PK-së, para, gjatë dhe pas protestës së 28 nëntorit të vitit 2015, si dhe të vlerësojë përputhshmërinë e veprimeve policore me bazën ligjore, përdorimin e forcës nga zyrtarët policor, evidentimin e rasteve tjera të mundshme nëse kërkojnë trajtim sipas autorizimeve ligjore të IPK-së si dhe dhënien e rekomandimeve për mënyrat e përmirësimit të kryerjes së detyrave policore në situata të ardhshme të mundshme.

2.3 Objekt i inspektimit të jashtëzakonshëm është përcaktuar menaxhimi i situatës nga strukturat policore të PK-së gjatë protestave të 28 nëntorit 2015, mënyrën e menaxhimit të operacionit policor në ditën kritike dhe veprimet pas-operacionale të saj.

2.4 Subjekt i këtij inspektimi ka qenë struktura policore që ka menaxhuar me informacionin e grumbulluar mbi protestën e paralajmëruar, struktura policore që ka ndërmarrë veprimet në fushën e planifikimit të veprimeve pro-aktive, reaktive dhe pas operative policore, struktura menaxhuese policore në udhëheqjen e operacionit dhe njësitë operative policore që kanë zbatuar urdhrat dhe planet policore në operacionin policor.

2.5 Me rastin e planifikimit të aktiviteteve në funksionalizimin e inspektimit të paralajmëruar, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së ka vënë këto objektiva të inspektimit:

- Vlerësimi i organizimit/planifikimit për menaxhimin e protestës së datës 28.11.2015;
- Vlerësimi i respektimit të infrastrukturës ligjore në menaxhimin e situatës gjatë manifestimit të datës 28.11.2015;
- Vlerësimi i respektimit të rregullave ligjore për përdorimin e forcës nga zyrtarët policor të datës 28.11.2015;

2.6 Duke pasur parasysh faktin se IPK-ja është një agjenci ekzekutive që zhvillon në mënyrë të pavarur funksionet e saj të bazuara në Ligjin nr. 03/L-231 për IPK-në, nga organizata pritet të jepet një vlerësim real mbi gjithë atë që është zhvilluar më 28 nëntor 2015, në sheshet kryesore të Kryeqytetit dhe rrugët që shpjen tek to. Me këtë vlerësim pritet që:

- të vlersohet mënyra e menaxhimit të situatës nga struktura policore e kyçur në operacion policor,
- të vlerësohet niveli profesional i strukturës policore në menaxhimin policor, para taksapaguesve, të cilët presin shërbime efikase, efektive dhe të përgjegjshme,
- të jepet një pasqyrë reale mbi PK-në në respektimin e të drejtave të qytetarëve për të protestuar,
- të jepet një kontribut në ofrimin e rekomandimeve profesionale në përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve policore,
- të ngritet transparenca mbi aktivitetet policore në raport me qytetarët e vendit, me qëllim të thellimit të besimit të qytetarëve në forcën policore.

2.7 E autorizuar të kryejë inspektim të jashtëzakonshëm, IPK-ja ka angazhuar inspektorët, të cilët në vazhden e nxjerrjes së informacionit të duhur, kanë siguruar:

- të dhëna nga materialet audio vizuale të siguruara nga shtëpitë mediatike, pamje këto të transmetuara në opinion publik, si dhe ato të siguruara nga njësitë policore që kanë kryer incizime në vendngjarje në ditën e protestave,
- dokumente të shkruara, si raporte të ndryshme, plane dhe urdhra operativë, radiologe, njoftime, fotografi dhe letra korrespondence, dhe
- intervista nga punonjës policorë të nivelit të lartë drejtues, të nivelit zbatues dhe qytetarë të përfshirë në protestë, si në vijim:
  - Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës për Operativë;
  - Udhëheqësi i Përgjithshëm i Operacionit;
  - Drejtori i Departamentit të Hetimeve të Krimit;
  - Udhëheqësi i Dhomës Komanduese në DPP;
  - Drejtori i Divizionit të Njësive të Specializuara;
  - Drejtori i Drejtorisë së Njësive Speciale;
  - Komandanti i Njësive Speciale Operative;
  - Komandanti i Njësive Speciale Intervenuese;
  - Zv. Komandanti i Njësive Speciale Intervenuese;
  - Drejtori Rajonal në Prishtinë;
  - Zv. Drejtori Rajonal në Prishtinë
  - Komandantet taktik të stacioneve policore në DRP-Prishtinë;
  - Zyrtarë policor të përfshirë në planin operativë në detyrë datën konkrete;

2.8 Inspektimi i jashtëzakonshëm i zhvilluar nga inspektorët e Departamentit të Inspektimit (asistuar edhe nga hetues të Departamentit të Hetimeve) është përqendruar në këto fusha kryesore:

- Veprimet policore në planifikimin e aktiviteteve për menaxhimin e situatës,
- Veprimet policore gjatë zgjedhës së ngjarjes së datës 28.11.2015,
- Veprimet policore pas operacionale,
- Infrastruktura Ligjore,
- Përdorimi i forcës nga zyrtarët policorë.

2.9 Inspektimi i jashtëzakonshëm i autorizuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Konventa ndërkombëtare për Mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut;
- Ligji i Policisë së Kosovës (2011 /04-L-076);
- Ligji për Tubimet Publike (2009/03-L-118);
- Ligji Për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri, (2010/03-l-2460);
- Udhëzimi Administrativ për Përdorimin e Forcës nga ana e Zyrtarëve Policor (Nr. 02/2012);
- Udhëzimi Administrativ për Përdorimin e Armëve të Zjarrit nga Zyrtarët Policor;
- Parimet dhe Procedurat e PK-së;
- Koncepti për ballafaqim me turma;



### **3. VLERËSIMI I ORGANIZIMIT/PLANIFIKIMIT, DHE MENAXHIMI I SITUATËS GJATË MANIFESTIMIT TË DATËS 28.11.2015**

---

#### **3.1 Veprimet planifikuese përgatitore policore**

3.1.1 Kundërshtimet e partive opozitare sa i përket marrëveshjes së arritura në Bruksel në mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë lidhur me formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe Demarkacionit me Malin e Zi, kishin bërë që këto parti të paralajmërojnë organizimin e një Manifestim-Protestë sa i përket çështjeve të cekura më lartë. Këto paralajmërimë kishin potencuar datën 28 Nëntor si ditë të mbajtjes së Manifestimit-Protestës dhe organizatorët këtë njoftim e kishin bërë nëpërmjet njoftimit në media dhe mjete tjera të komunikimit elektronik.

3.1.2 Duhet theksuar që referuar dokumentacioneve të siguruara organizatorët e protestës nuk kishin lajmëruar zyrtarisht mbajtjen e manifestimit-protestës në Policinë e Kosovës siç parasheh Ligji Për Tubimet Publike<sup>1</sup>. Po ashtu Prokuroria e Shteti me datë 09.11.2015, kishte lëshuar Urdhër Arrest për katër deputetë të partive opozitare nën dyshime se kanë kryer veprë penale<sup>2</sup>, ku në ndërkohë njëri nga ta ishte arrestuar kurse tre të tjerët nuk ishin paraqitur para organeve përgjegjëse të drejtësisë dhe ishin në kërkim nga policia.

3.1.3 Mirëpo bazuar në paralajmërimet e partive opozitare përmes medieve ku kishin informuar për organizimin e manifestimit/protestës si dhe duke u bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të situatës së krijuar shoqërore e politike si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit në vend, Policia e Kosovës në sajë të autorizimeve dhe detyrave policore që burojnë nga ligji ka ndërmarrë veprimet përgatitore planifikuese për menaxhimin e situatës dhe ofrimit të sigurisë, rendit dhe qetësisë publike. Pas këtij paralajmërimi, nga ana e strukturave përgjegjëse të PK-së, ishte bërë vlerësimi i shkallës së sigurisë ku ishte hartuar Urdhri Operativ nga DPP. Po ashtu, si rezultat i hartimit të Urdhrit Operativ nga DPP, ishin hartuar Planet Operative nga ana e DRP-Prishtinë, Departamentit të Hetimeve si dhe Divizionit për Njësi të Specializuara pranë DPP-së.

3.1.4 Para çdo veprimi përgatitor planifikues si reagim në situata me rastin e organizimeve të protestave qytetare kërkohet një raport analitik i vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë të cilin e harton Drejtoria për Inteligjencë dhe Analiza duke u bazuar në mbledhjen e informacioneve inteligjente të policisë. Pra, para hartimit të Urdhrit Operativ nga Departamenti për Operacione i DPP-së fillimisht ju është bërë kërkesë DIA-së për vlerësim të shkallës së rrezikshmërisë, brenda një kohe optimale të kufizuar. Përveç kërkesës në formën e shkruar Sektori për Planifikim Permanent i Departamentit të Operacioneve, vazhdimisht ka mbajtur të hapur vijën e komunikimit me DIA edhe në format tjera të komunikimit dhe konsultimeve të vazhdueshme lidhur më informacionet dhe rrjedhën e ngjarjeve.

3.1.5 Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë e PK-së, duke u bazuar në kërkesën e Departamentit për Operacione me datë 23.11.2015, kishte hartuar një raport analitik "Vlerësimi i situatës së sigurisë me rastin e festës Kombëtare të ditës së Flamurit 28 nëntor – manifestim/protesta paqësore të Bllokut Opozitar" me numër reference DIA#60689. Në këtë raport analitik fillimisht ishte bërë një përshkrim i shkurtër i rëndësisë që ka data 28 Nëntori për popullin Shqiptar si dhe për historikun dhe mënyrën e festimit të kësaj date në

---

<sup>1</sup> Ligji për Tubimet Publike Nr. 03/L-118 neni 6 par. 1,2

<sup>2</sup>Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda /Urdhër Arrest/ PPRKR. Nr. 413/15;



Republikën e Kosovës, duke potencuar se në të gjitha qytetet e Republikës së Kosovës organizohen programe të ndryshme kulturore sportive dhe argëtuese.

3.1.6 Gjithashtu në këtë raport analitik është paraqitur historiku i ngjarjeve të ndodhura gjatë kundërshtimit të marrëveshjeve duke penguar mbajtjen e seancave të rregullta të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga ana e deputetëve të partive politike opozitare, duke përfshirë këtu edhe metodat dhe mjetet e përdorura për pengimin e mbajtjes së seancave të Kuvendit, ku si pasojë e këtyre veprimeve Prokuroria e Shtetit kishte lëshuar katër (4) urdhër arreste për deputetët e partive opozitare. Vlen të theksohet se në këtë raport analitik janë paraqitur të dhënat rreth zhvillimit të protestës së dhunshme të datës 18 nëntor 2015, të mbajtur nga Blloku Opozitar pas arrestimit të një (1) deputeteje.

3.1.7 Sa i përket vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë, në këtë raport analitik, DIA nuk kishte paraparë se kishte informacione se ky manifestim paqësor-protestë do të eskalonte në protestë të dhunshme, por duke marrë parasysh deklaratimet publike të partive opozitare, se me çdo kusht do të pengohet realizimi i këtyre marrëveshjeve, nuk përjashtohet mundësia që edhe ky manifestim-protestë të përcillet me akte të dhunshme-incidente të izoluar. Gjithashtu këtu potencohet se duke u bazuar në zhvillimet aktuale politike dhe paralajmërimin për organizimin e një manifestimi-protestë paqësore nga blloku opozitar, vlerësohet se rrezikshmëria gjatë mbajtjes së këtij manifestimi më 28 Nëntor 2015, në Sheshet e Prishtinës është i nivelit **MESATAR-LARTË**<sup>3</sup>.

3.1.8 Pas vlerësimit të shkallës së nivelit të rrezikshmërisë që kishte nxjerrë DIA në raportin e cekur më lartë, Sektori për Planifikim Permanent në kuadër të Departamentit për Operacione në Drejtorinë e Përgjithshme të PK bashkë me Drejtorin për Operacione, në përputhje me udhëzuesin për Hartimin e Urdhrave dhe Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore është kompetente të hartojë urdhra Operativë. Është detyrë e këtij sektori që ti përgjigjet çdo kërkesë që vjen prej drejtorive dhe njësisve policore të cilat kërkojnë veprime përgatitore dhe planifikuese për operime policore<sup>4</sup>.

3.1.9 Me datë 25.11.2015 nga DPP është hartuar dhe aprovuar një Urdhër Operativ “28 Nëntori 2015” Në këtë Urdhër Operativ janë dhënë në mënyrë të detajuar udhëzimet dhe detyrat për të gjitha njësitet policore lidhur me menaxhimin e situatës gjatë datës 28 Nëntor 2015, datë kur do të ketë organizim të manifestimeve të ndryshme kulturore dhe festive, ku gjithashtu pritet që të mbahet edhe manifestimi-protestë i thirrur nga Blloku Opozitar i Partive Politike Shqiptare. Andaj qëllimi i këtij Urdhri Operativ ishte<sup>5</sup>:

- Mbajtja e rendit, qetësisë dhe sigurisë publike dhe zbatueshmëria e Ligjit;
- Ofrimi i sigurisë në vendet ku do të organizohen aktivitetet, manifestimet kulturore sportive dhe ato artistike;
- Ndërmarrja e masave të nevojshme preventive, operative policore për të siguruar që mbarëvajtja e tubimit/protestës të paralajmëruar të kalojë pa ndonjë incident, ndërmarrja e masave të sigurisë që mbarëvajtja e saj dhe pjesëmarrësit në të, të shprehin qëllimin e tyre në mënyrë demokratike dhe në suaza Ligjore;
- Kontrollimi i shfaqjes së turmave në rastin e eskalimit të protestës nga ajo e QETË në atë të DHUNSHME me përmasa të ndryshme;

<sup>3</sup> Raport Analitik/ "Vlerësimi i Situatës së Sigurisë më rastin e Festës Kombëtare të Ditës së flamurit 28 nëntor-Protesta Paqësore të bllokut Opozitar/ Datë:23/11/2015/ DIA#60689;

<sup>4</sup> Intervista me Shefin e Sektorit për Planifikim Permanent në kuadër të Departamentit për Operacione të PK-së;

<sup>5</sup> Urdhër Operativ "28 Nëntori 2015" Datë: 25.11.2015/ Ref: DDO 04-128-2015

- Mbrojtja e jetës, pronës dhe pasurisë së qytetarëve dhe asaj shtetërore;
- Garantimi i lirisë së lëvizjes dhe shprehjes.

3.1.10 Sipas këtij Urdhri Operativ përgjegjës për ndërmarrjen e masave të sigurisë do të jetë Departamenti i Operacioneve në bashkëpunim me Departamentet tjera. Njëkohësisht Departamenti për Operacione ka ngrit masat e sigurisë dhe vigjilencën policore lidhur me zhvillimet e fundit në rajon dhe me gjerë, sa i përket kërcënimeve nga aktet e mundshme terroriste.

3.1.11 Duke u bazuar në të dhënat e cekura më lartë, me rastin e nxjerrjes dhe hartimit të Urdhrave Operativ bëhet edhe përcaktimi i strukturave policore të cilat duhet angazhuar në detyrë me rastin e menaxhimit dhe ballafaqimit më situatën konkrete. Është në kompetencë të Departamentit për Operacione në kuadër të DPP-së që vendos se cilat njësi dhe kush nga strukturat policore duhet të kyçet në një operacion policor. Me këtë urdher operativ është paraparë që të gjitha njësitet policore të jenë të angazhuara çoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në gjendje gatishmërie, varësisht nga rrjedha e situatës kur të kihet parasysh kriteri i vlerësimit të situatës politike shoqërore pas ngjarjeve të fundit në vend.

3.1.12 Urdhri Operativ hartohet si dokument planifikues përgatitor në vija të trasha i cili iu dedikohet drejtorive dhe njërive policore me qëllimi të konkretizimit dhe detalizimit të veprimeve të kërkuara për realizimin e planeve operative. Pas hartimit të Urdhrit Operativ, aprovimin e tij në kuadër të strukturës organizative të PK-së është pozita e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm për Operativë të Policisë së Kosovës, rregull i cili është respektuar në rastin konkret.

3.1.13 Duke u bazuar në Urdhrin Operativ me numër reference DDO 04-128-2015 të datës 25.11.2015, të lëshuar nga DPP, si dhe duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga ky Urdhër Operativ, Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë me datë 26.11.2015 ka hartuar Planin Operativ “Manifestim - 28 Nëntor 2015” me numër reference 04/1-01 SOR/064/2015.

3.1.14 Në këtë Plan Operativ janë të përcaktuara në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për njësitet policore të përfshira me këtë plan duke i përcaktuar saktësisht vendin e veprimit dhe numrin e zyrtarëve policor që do të jenë të angazhuar. Njëkohësisht janë caktuar udhëheqësi i operacionit nga DRP, komandantët taktik në teren si dhe përgjegjësit e njërive për mbështetje si hetimet, njësia për transportin e të arrestuarve, njësit e komunikacionit rrugor etj.

3.1.15 Vlen të theksohet se në këtë Plan Operativ janë parapara edhe tri situata të mundshme të rrjedhës së Manifestimit/Protestës: kur protesta është e qetë; kur manifestimi - protesta fillon e qetë por eskalon si dhe kur manifestimi-protesta është e dhunshme. Gjithashtu janë paraparë dhe format e menaxhimit në të tri situatat duke përfshirë edhe angazhimin e njërive përkatëse policore varësisht prej rrjedhës së ngjarjes.<sup>6</sup>

- Kur manifestimi - protesta është e qetë/ përkujdesja për rend dhe qetësi publike nga njësitet e rendit, ndërsa njësitet e specializuara të jenë sa më pak të ekspozuara para masës duke qëndruar në gjendje gatishmërie për intervenim të mundshëm.
- Kur manifestimi - protesta fillon e qetë, por eskalon/ Njësitet e rendit pas eskalimit duhet të tërhiqen në mënyrë taktike për t’iu mundësuar njërive të specializuara

<sup>6</sup> Planin Operativ “Manifestim - 28 Nëntor 2015” Ref: 04/1-01 SOR/064/2015;

(NJRSH, Togu Rezervë apo edhe NJSO) të veproj në raport me situatën e krijuar. Në këtë rast njësitet e rendit duhet të qëndrojnë në prapavijë të njësiteve të specializuara duke i përkrahur këto njësi në arrestimin e personave të dhunshëm dhe dërgimin e tyre tek njësia e transportit. Pas avancimit të njësiteve të specializuara situatën e sigurisë në lokacion do të mbikëqyrin njësitet e rendit. (duhet të aplikohet forma e arrestimit të personave).

- Kur manifestimi-protesta është e dhunshme/ Në këtë rast njësitet e rendit të pozicionuara para objekteve në përkujdesje të rendit dhe qetësisë publike duhet të tërhiqen për të ndërhyrë njësitet e specializuara, NJRSH, Togu Rezervë dhe NJSO duke përdorë mjete speciale për shpërndarjen e turmave.

3.1.16 Në të gjitha rastet e paralajmërimeve të organizimit të manifestimeve dhe protestave qytetare Njësitet e Specializuar të PK-së parashihen të qëndrojnë në Gjendje Gatishmërie, varësisht prej rrjedhës së situatës dhe përshkallëzimit të saj fazat e veprimit të këtyre njësiteve ndryshojnë. Në sajë të veprime përgatitore dhe angazhimeve të Njësiteve të Specializuara, Divizioni i Njësiteve të Specializuara DPP ka hartuar Planin Operativ "28 Nëntori", i datës 26 .11.2015 Ref. 04-02/OPS 939/2015. Në bazë të këtij Plani Operativ me datën 28 nëntor potencohet se do të angazhohen të gjitha Njësitet e Specializuar në kuadër të këtij divizioni.

3.1.17 Bazuar në situatat në të kaluarën, se si kanë rrjedhur ngjarjet gjatë protestave si dhe në pamundësi të koordinimit dhe bashkëpunimit të mirëfilltë në mes të organizatorëve të protestës dhe Policisë së Kosovës kjo e fundit me qëllim të menaxhimit më të mirë të situatës në planet e saja operative ka përfshi tri variante të mundshme të rrjedhës së ngjarjes:

- A. Varianti i parë:** Parashih situatën kur organizohen protesta të **qeta**, ku pikësynimi i tyre për të protestuar mund të jenë institucionet vendore duke mos përjashtuar edhe ato ndërkombëtare. Këto protesta janë paralajmëruar të mbahen në Prishtinë por duke mos përjashtuar edhe lokacione tjera.
- B. Varianti i dytë:** Parashih situatën kur kemi organizime dhe ardhje masive të qytetarëve nga vendbanimet e tyre në drejtim dekoncentrim tek Institucionet qendrore të RKS-së, ku mund të kemi protesta të cilat mund të eskalojnë nga ato të **qeta** në të **dhunshme**.
- C. Varianti i tretë:** Parashih situatën kur kemi protesta/trazira publike direkt të **Dhunshme** më përmasa nga ato të vogla, mesme dhe të mëdha, në një lokacion apo në shumë vende.<sup>7</sup>

3.1.18 Në bazë të këtij plani operativ të gjitha Njësitet e Specializuara në kuadër të Divizionit për Njësi të Specializuara do të mobilizohen dhe qëndrojnë në gjendje gatishmërie për veprim varësisht rrjedhës së ngjarjeve dhe nevojës për intervenim si: Drejtoria për Sigurinë e Objekteve me Rendësi të Veçantë dhe Personaliteteve (DSORVP), Njësia për Mbrojtjen e Afërt (NJMA), Njësia Speciale Intervenuese (NJSI), Njësia për Mbrojtjen nga Eksplozivët (IEDD) dhe Njësi me Qen(K9), Njësia Speciale Operative (NJSO). Udhëheqës i Planit Operativ për Divizionin e Njësiteve të Specializuara është pozita e Drejtorit të këtij divizioni.

3.1.19 Departamenti i Hetimeve në kuadër të DPP-së në sajë të planifikimit dhe përgatitjes së angazhimeve që dalin nga Urdhri Operativ nr. DDO 04-128-2015 ka hartuar planin Operativ "28 Nëntori" të datës 26/11/2015 Ref. DDH/06/222/2015. Në bazë të këtij plani

---

<sup>7</sup> Urdhri Operativ "28 nëntor 2015" Ref. DDO 04-128-2015; Planin Operativ "Manifestim - 28 Nëntor 2015" Ref: 04/1-01 SOR/064/2015

ngritët gatishmëria dhe angazhime i të gjitha njësive në kuadër të këtij departamenti përfshirë edhe njësitet hetimore nga Drejtoritë Regjionale që do të jenë në mbështetje të këtij operacioni. Udhëheqës i këtij Plani Operativ nga Departamenti i Hetimeve të DPP-së ka qenë pozita e Drejtorit të Departamentit të Hetimeve të Krimin në Kuadër të DPP-së.

3.1.20 Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës (DIA) ka qenë e angazhuar në grumbullimin e informacioneve nga terreni lidhur me organizimet dhe planifikimet për ndonjë incident të mundshëm. Njësitet nëpër rajone kanë njoftuar lidhur me organizimet që kishin filluar të bëheshin nga orët e mëngjesit për ardhjen në Prishtinë, ku nga ora 11:00 kanë filluar me i përcjellë informacionet nga secila komunë e Kosovës lidhur me numrin e autobusëve, kombi-busëve dhe numrin e udhëtareve që po niseshin në mënyrë të organizuar për në Prishtinë.

3.1.21 Gjatë analizimit të dokumentacioneve të sipër përmendura, Inspektorët nuk kanë gjetur të dhëna të cilat tregojnë se ishte planifikuar edhe arrestimi i deputetëve të cilët kanë urdhër arrest të lëshuar nga prokuroria e shtetit, në rast se ata do të marrin pjesë në manifestimin-protestë të organizuar nga Blloku Opozitar i Partive Politike Shqiptare. Mirëpo duhet theksuar se, si në Urdhrin Operativ ashtu edhe në Planet Operative të secilit nivel që i përshkruam më lartë është potencuar në formë të informatës se ndaj tre deputetëve ekziston urdhër arresti i lëshuar nga prokuroria e shtetit. Po ashtu në secilin plan operativ të hartuar është potencuar si vërejtje se plani operativ mund të pësojë ndryshime varësisht se si rrjedh ngjarja gjatë zhvillimit të këtij manifestimi-proteste.

3.1.22 Sa i përket çështjes së arrestimit të deputetëve ndaj të cilëve Prokuroria e Shtetit kishte lëshuar urdhër arrestet, DP e Policisë më datë 17.11.2015 kishte hartuar dhe aprovuar dy Urdhra Operativ, pra, Urdhrin Operativ “Zbatim i Urdhërësave të Gjykatës” me numër reference DDO 04-124-2015 dhe Urdhri Operativ “Zbatimi i Urdhrave të Ligjshëm të Organeve Kompetente” me numër reference DDO04-125-2015.

3.1.23 Urdhri Operativ “Zbatimi i Urdhërësave të Gjykatës”, është hartuar me qëllim që të bëhet:

- Zbatimi dhe Ekzekutimi i Urdhërësës së organeve kompetente të drejtësisë ndaj katër (4) Deputetëve për të cilët është lëshuar urdhër arresti,
- Lokalizimi, konfirmimi i prezencës së të lartcekurve në adresën e caktuar, njoftimi dhe dorëzimi i Urdhërësës së Gjykatës kompetente, ndalja/shoqërimi apo edhe arrestimi i tyre si dhe ndërmarrja e masave pasuese Ligjore, dhe
- Dorëzimi i tyre para organeve kompetente për procedurë të mëtutjeshme Ligjore.

3.1.24 Në këtë Urdhër Operativ janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësit për të gjitha njësitet policore të cilat do të jenë të involvuara në këtë operacion. Është kërkuar nga Divizioni për Siguri Publike (DSP) që të përpiloj Planin Operativ të mbaj kontakte të vazhdueshme me të gjithë të involvuarit në këtë UO, për koordinim dhe veprim në terren gjatë implementimit të këtij Plani Operativ. Nga Departamenti i Hetimeve është kërkuar që përmes inteligjencës të mblidhen informacione për konfirmimin e prezencës së tyre në territorin e RKS-së, DIA të bëjë vlerësimin e situatës në vazhdimësi dhe për çdo informacion relevant të dërgohet me kohë tek udhëheqësi i operacionit. Kurse nga Divizioni i Njësive të Specializuara (Njësitë: NJSO, K-9, IEDD, NJMA dhe NJSI) është kërkuar që të jenë të gatshme për angazhime dhe intervenime sipas kërkesave apo nevojave aty për aty.

3.1.25 Ndërsa Urdhri Operativ “Zbatimi i Urdhrave të Ligjshëm të Organeve Kompetente”, parasheh situatat që mundë të ndodhin pas arrestimit të Deputetëve ndaj të cilëve është lëshuar Urdhër Arresti, duke përcaktuar njëkohësisht detyrat dhe përgjegjësit e të gjitha njësive policore të involvuara në këtë PO. Qëllimi i këtij Urdhri Operativ ishte:

- Zbatimi dhe Ekzekutimi i Urdhrave të Ligjshëm të organeve të Drejtësisë,
- Ruajtja e rendit, qetësisë dhe sigurisë publike dhe zbatueshmëria e Ligjit,
- Ndërmarrja e masave të nevojshme preventive, operative policore për të siguruar që mbarëvajtja e ndonjë tubimi eventuale të kalojë pa ndonjë incident, në rast të organizimit të ndonjë proteste/ demonstrate ndërmarrja e masave të sigurisë që mbarëvajtja e saj dhe pjesëmarrësit në të, të shprehin qëllimin e tyre në mënyrë demokratike dhe në suaza Ligjore,
- Mbrojtja e jetës, pronës dhe pasurisë së qytetarëve dhe asaj shtetërore,
- Garantimi i lirisë së lëvizjes dhe shprehjes.

3.1.26 Vlen të theksohet që si rrjedhojë e ngjarjeve të shkaktuara nga situata politike në vend që nga gushti i vitit 2015, si dhe urdhëresës së lëshuar nga gjykata kompetente për ndaljen/shoqërimin apo edhe arrestimin e disa deputetëve kishte autorizuar Policinë e Kosovës që të zbatojë urdhëresën e lartcekur. Andaj, Policia e Kosovës në përputhje me kompetencat dhe autorizimet ligjore me qëllim të ekzekutimit të vendimeve të ligjshme të organeve kompetente të drejtësisë dhe atë konkretisht Departamenti për Operacione kishin përpiluar dy urdhra operativ “Zbatimi i Urdhrave të Ligjshëm të organeve kompetente” dhe “ Zbatimi i Urdhëresave të Gjykatës”<sup>8</sup> të cilët kanë qenë aktiv edhe gjatë datës 28 nëntor. Për shpjegime të mëtejme si rezultat i këtyre dy urdhrave operativ Divizioni i Njësive të Specializuara i PK-së me datën 21.08.2015 kishte hartuar Planin Operativ, “Gatishmëria Vepruese” Nr Ref. 04-02/OPS655/2015, kurse Njësia Speciale Operative kishte përpiluar Planin Taktik aneks nga plani operativ “Patrullime dhe Pika Kontrolluese” Nr. Ref. 04/02-NJSO- Pr/291/2015 i datës 16.11.2015.

## **3.2. Veprimet policore operative gjatë protestës të zhvilluar me 28 Nëntor 2015**

3.2.1 Lidhur me menaxhimin e situatës gjatë zhvillimit të manifestimit-protestës së datës 28 Nëntor 2015, IPK është bazuar në radiologun e mbajtur nga Dhoma Komanduese DPP, si dhe thirrjeve telefonike që janë zhvilluar në mes të zyrtarëve policore nga dhoma komanduese dhe komandanteve taktik nga tereni. Pra, duke u bazuar në këtë radiolog IPK ka vërejtur se të gjitha dhomat komanduese me përbërje të plotë të Drejtorive Regjionale duke përfshirë edhe dhomën komanduese të DPP-së janë hapur në ora 10:00, ashtu siç ka qenë e paraparë edhe me UO “28 Nëntori 2015”. Të gjitha Drejtoritë Regjionale krahas informatës për hapjen e dhomave komanduese kishin njoftuar Dhomën Komanduese të DPP-së edhe për organizimin nga ana e tyre të pikave të kontrollit duke i precizuar edhe vendet e organizimit të pikave të kontrollit, si në rrugët lokale, regjionale dhe në autostradë.

3.2.2 Duke filluar nga ora 10:10 kanë filluar që të vijnë informacionet nga Drejtoritë Regjionale, lidhur me fillimin e grumbullimit të qytetarëve nëpër qendra të ndryshme të qyteteve të Kosovës me qëllim të udhëtimit në formë të organizuar (me autobus) në drejtim të Prishtinës ku edhe do të zhvillohej manifestimi-protesta. Në këto informacione janë të përfshira edhe të dhënat lidhur me numrin e qytetarëve të grumbulluar, numri i autobusëve,

---

<sup>8</sup> Urdhri Operativ “Zbatimi i Urdhrave të Ligjshëm të organeve kompetente /Datë: 17.11.2015/Ref: DDO 04-125-2015;

Urdhri Operativ “Zbatimi i Urdhëresave të Gjykatës Datë 17.11.2015/ Ref: DDO 04-124-2015;

emri i kompanisë transportuese, targat e regjistrimit të autobusëve, numrin e veturave, urdhrat e dhënë, njësitë e angazhuara ngjarjet e zhvilluara në teren. Komunikimi zyrtarë në mes të udhëheqësve të Dhomës Komanduese dhe atyre nga terreni është bërë nëpërmes radiolidhjeve dhe komunikimit telefonik. IPK ka gjetur së informatat e shkëmbyera përmes thirrjeve telefonike nuk janë të tëra të përfshira në përmbajtjen e logut të ngjarjes. Gjithashtu referuar “Udhëzuesit për Hartimin e Urdhrave dhe Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore” këto komunikime mund të aplikohen vetëm në rastet kur nuk ka alternativë tjetër<sup>9</sup>.

3.2.3 Nga paraqitja e të dhënave në radiolog shihet se Dhoma Komanduese në vazhdimësi ka qenë e informuar rreth zhvillimit të ngjarjeve në teren nga të gjitha qendrat e Kosovës. Në ora 11:42 ishte dhënë edhe informata se një grup prej 50 personave me shirita të kuq lëviznin nga Gjykata Kushtetuese në drejtim të Hotelit Grand. Informatë e njëjtë për lëvizjen e rreth 200 personave me shirita të kuq nga Gjykata Kushtetuese në drejtim të Sheshit “Zahir Pajaziti” ishte evidentuar edhe në ora 12:55.

3.2.4 Njësitet tjera të hetuesisë nga Departamenti i Hetimit të Krimin të ndarë në 6 togje<sup>10</sup> kanë qenë të angazhuar në vrojtimin dhe përcjelljen e personave të kërkuar me fletë arrest. Këto njësi kishin operuar në rroba civile duke i mbuluar të gjitha rrugët kryesore të Prishtinës. Njëkohësisht detyrë e tyre ka qenë që nëse shihen dhe identifikohen të gjithë personat ndaj të cilëve ka pasur fletë arreste nga gjykata të vëzhgohen dhe të njoftohen eprorët e lartë.

3.2.5 Sa i përket grumbullimit të qytetarëve në sheshin “Zahir Pajaziti” (Vendi i përcaktuar për mbajtjen e manifestimit/protestës), informatat e para të evidentuara në radio-log janë duke filluar nga ora 12:57 dhe kanë vazhduar deri me fillimin e manifestimit/protestës. Sipas radiologut protesta ka filluar në ora 14:10, fillimisht me antonimin e Himnit të Flamurit Kombëtar pastaj me mbajtjen e fjalimeve të tre liderëve të partive politike opozitare. Në ora 14:34 masës së tubuar ju ka drejtuar me një fjalim edhe deputeti Albin Kurti (deputet ndaj të cilit ishte lëshuar urdhër arresti) fjalim i cili ka zgjatur deri në ora 14:50 kur edhe moderatorin e tubimit e shpall të përfunduar manifestimin duke kërkuar nga masa e tubuar që të vazhdojnë me manifestimet nëpër Prishtinë sipas organizimit të KK Prishtinë.

3.2.6 Në radiolog në ora 14:41 (interval kohor ky kur ishte duke e mbajtur fjalimin Deputeti Albin Kurti) është evidentuar edhe urdhri i dhënë nga Udhëheqësi i Operacionit, ku urdhëroheshin të gjithë zyrtarët policor të jenë vigjilent dhe të mos bien në provokime. Gjithashtu në radiolog janë të evidentuara edhe informatat rreth rrjedhës së shpërndarjes së turmës duke përfshirë edhe informatat rreth lëvizjes së deputetit Albin Kurti si dhe rreth numrit të personave (aktivistëve) të cilët e shoqëronin atë.

3.2.7 Gjatë rrjedhës së ngjarjes dhe zhvillimit të protestës së qetë në Sheshin “Zahir Pajaziti” NJSO dhe NJSI kanë qëndruar në Gjendje gatishmërie, në pritje për intervenim vetëm nëse situata e kërkon nevojën e ndërhyrjes së tyre. Intervenimi i NJSO-së në protestën e 28 nëntorit ka ndodhur vetëm pas lëvizjes së një grupi apo turmë protestuesish të cilët kishin marr drejtimin e selisë së VV-së, bashkë me deputetin Albin Kurti. Me këtë rast angazhimi i togjeve të NJSO-së ka qenë sigurimi i perimetrit të parë rreth selisë së lëvizjes VV<sup>11</sup>.

<sup>9</sup> Udhëzuesit për Hartimin e Urdhrave dhe Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore pika 5. Komunikimi par. 5.2

<sup>10</sup> Departamenti i Hetimeve /Raporti Pas-Operacional/ Ref: DHH/06/222/2015;

<sup>11</sup> Intervistim me Eprorët e NJSO-së.

Ballafaqimi me turmën protestuese ka qenë afër selisë së VV-së, ku turma protestuese prej 200-300 sipas informatave të paraqitura në log, ishin tubuar para selisë së VV-së. Gjatë këtij ballafaqimi me turmën jashtë selisë VV njësitet policore të NJSO-së kishin përdorur sprej OC dhe shufrat e gomës për të neutralizuar rezistencën e një grupi protestuesish të cilët përpiqeshin të pengonin avancimin e njësive policore drejtë Selisë së lëvizjes VV-së<sup>12</sup>.

3.2.8 Në ora 15:41 nga Dhoma Komanduese e DPP-së, konkretisht nga Udhëheqësi i Operacionit së bashku me Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm për Operacione të PK-së dhe Drejtorin e Departamentit të Hetimeve, është dhënë urdhri përmes radiolidhjes që të arrestohen të gjithë personat me Urdhër Arrest të gjykatës. Gjithashtu Udhëheqësi i Operacionit ka urdhëruar që secila njësi të veproj me detyrat konkrete me kohë veprimi 30 sekonda. Sipas intervistave të zyrtarëve të NJSO-së, njësitet e kësaj të fundit kishin arritur të pastrojnë terrenin para selisë së lëvizjes VV-së duke i krijuar hapësirë njësive të NJSI-së që të hyjë në objektin e selisë së VV-së. Në ora 15:52 nga Udhëheqësi për NJSO, kishte informuar se njësitet e NJSI kanë arritur të hyjnë në Selinë e LVV<sup>13</sup>.

3.2.9 Pas dhënies së urdhrit për intervenim dhe ndërhyrjes në selinë e lëvizjes VV-së njësitet policore kanë intervenuar duke aplikuar tri perimetrat e nivelit të reagimit të njësive policore sipas rangut të kompetencës dhe përgatitjes profesionale policore të tyre për ballafaqimin me protesta të dhunshme. Në perimetrin e parë ishin angazhuar njësitet e NJSO-së të cilët kishin rrethuar selinë e Lëvizjes VV-së deri sa NJSI me operatorët e sajë kishte depërtuar brenda ambienteve të selisë së lëvizjes VV-së. Në perimetrin e dytë ishin vendosur njësitë policore të togjeve rezervë të cilat kishin krijuar kordon policore në perimetrin e rrugëve që qojnë tek selia e VV-së dhe kishin penguar turmat protestuese të cilët tentonin ti afroreshin selisë së kësaj lëvizje. Ndërsa në perimetrin e tretë të reagimit njësitet policore të rendit ishin angazhuar të asistojnë në rastet e arrestimit të personave, sigurimin dhe shoqërimin e tyre për në stacionet policore.<sup>14</sup>

3.2.10 Pas marrjes së urdhrit për ndërhyrje, NJSI ishte angazhuar që të ndërhyjë duke bërë hapjen e pengesës që ishte paraqitur në hyrje (derën) të selisë Vetëvendosje gjithnjë bazuar në përgatitjet e specializuara që posedon kjo njësi për të realizuar operacionin.<sup>15</sup> Referuar raportit Pas Operacional të DPP-së, në vendngjarje gjatë intervenimit në Selinë e VV-së kanë qenë dy prokurorë të shtetit.

3.2.11 Në radiolog vërehet se W/A (Komandanti i NJSO-së), vazhdimisht kishte informuar për zhvillimin apo rrjedhën e ngjarjes brenda Selisë së LVV, duke përfshirë edhe informatat rreth arrestimit të personave të cilët kanë rezistuar policinë si dhe arrestimin e Deputetit Albin Kurti. Sipas radiologut arrestimi i Deputetit Albin Kurti kishte ndodhë në ora 16:04. Mirëpo referuar intervistave të zhvilluara me përgjegjësit e NJSO-së asnjëri nga zyrtaret e kësaj njësie nuk ka hy brenda objektit të selisë së VV-së<sup>16</sup>.

3.2.12 Informatat në vazhdim kishin të bëjnë kryesisht rreth angazhimeve të zyrtarëve policor për vazhdimin e procedurave të zhvilluara për personat e arrestuar si: transporti i tyre, dhënia e ndihmës mjekësore, dërgimi në gjykatë etj<sup>17</sup>. Jashtë selisë së VV, kishte ndodhur ballafaqim i një grupit protestuesve të dhunshëm të cilët ishin përpjekur të

<sup>12</sup> Intervista me Eprorët e NJSO-së/Video-incizimet;

<sup>13</sup> Logu i DPP-së.

<sup>14</sup> Intervistat me Eprorët e Njësive policore të angazhuara operacion. (NJSO, Togjet rezervë, njësitet e rendit.

<sup>15</sup> PSO Njësia Speciale Intervenuese, pika 1.8 specialist për hapjen e pengesave.

<sup>16</sup> Intervista me Komandantin e NJSO-së dhe Shefi I NJSO-së Prishtinë.

<sup>17</sup> Raporti Pas Operacional DRP-Prishtina Ref. 04/1-01 SOR/064/2015



pengojnë njësitet policore të operojnë në detyrat policore. Në këtë intervenim dhe ballafaqim direkt me njësitet policore ka pasur disa persona të lënduar si rezultat i rezistencës dhe ballafaqimit direkt me njësitet policore të NJSO-së<sup>18</sup>.

3.2.13 Operacioni policor intervenues i njërive policore në selinë e VV, nga momenti i intervenimit hyrjes e deri tek zbrazja e objektit respektivisht arrestimi i Albin Kurtit dhe të tjerëve përfshinë intervalin kohor prej 25 minutash. Gjatë këtij intervali kohor numri i të arrestuarve kishte arritur afër 97 persona. Ndërsa gjatë operacionit nga ana e zyrtarëve policor ishin lënduar pesë (5) zyrtarë policor.<sup>19</sup> Për shkak të numrit të madh të personave të arrestuar, gjatë intervistave me zyrtarët policor të cilët kanë qenë të përfshirë në operacion ka pasur vërejtje së atë ditë ka pasur vonesa dhe pengesa më transportin e personave të arrestuar për shkak të numrit të madh të të arrestuarve brenda një intervali të shkurtër kohor<sup>20</sup>. Njësitet policore të NJSO-së kishin bërë ruajtjen dhe sigurimin e personave të arrestuar, të cilët i kanë shoqëruar ata deri tek njësi i transportit të personave të arrestuar i cili i kishte dërguar në objektin e Stacionit Policor Qendra në Prishtinë. Pas arrestimit, deputeti A. Kurti në Selinë e Lëvizjes VV-së, i përcjellur nën sigurinë e njërive speciale ishte dërguar për në gjykatë tek pallati i drejtësisë.

3.2.14 Pas arrestimit të 97 personave dhe qetësimit të situatës, njësitet policore të NJSO-së në ora 16:23 janë tërhequr në Stacionin Policor Qendra në Prishtinë dhe brenda oborrit të Qeverisë nga pozita intervenuese në atë të gjendjes së gatishmërisë në pritje të nevojës së intervenimit varësisht nga rrjedha e situatës dhe urdhrave për angazhim<sup>21</sup>.

3.2.15 Brenda Stacionit Policor Qendra në hapësirat e sallës së brifingut të këtij stacioni ishin mbajtur të gjithë personat e arrestuar. Njësitet policore rezervë në Stacionin Policor Qendra Prishtinë nën përgjegjësi të zyrtarëve policor me gradën kapiten dhe toger policor që kanë qenë të caktuar në plan operativ ishin përkujdesur për pranimin dhe sigurimin e personave të arrestuar, mbarëvajtjen e rendit dhe qetësisë brenda stacionit policor. Këto njësi kanë qenë përgjegjës për tu kujdesur për sigurinë e personave të arrestuar nga momenti i pranimit nga ana e njësitit të transportit e deri në kohën e dorëzimit të tyre tek njësitet hetuese për procedurat e intervistimit dhe hetimit<sup>22</sup>.

3.2.16 Pas ndërhyrjes së NJSI-së brenda selisë së LVV-së, arrestimeve të kryera PK-ja kishte kërkuar nga prokuroria leje për kontroll në seli. Pas kësaj kërkesë të parashtruar nga PK-ja ishte zhvilluar komunikimi përmes thirrjeve telefonike në mes të prokurores së çështjes, gjyqtarit të procedurës paraprake dhe Departamentit të Hetimeve të PK-së, me ç'rast prokurorja e rastit kishte aprovuar urdhrin verbal përmes telefonit në ora 15:51 për kontroll në objektin e VV-së. Pas marrjes së urdhrin njësitë kompetente të PK-së kishin filluar me kontrollin e objektit. Po ashtu në selinë e VV-së kanë qenë prezent edhe dy prokurorët kujdestar të rastit të cilët kishin udhëzuar që të fillohet me kontroll, por që të njëjtit nuk kanë qëndruar në objektin kur kishte filluar kontrolli i zyrave të selisë. Deputetëve të Lëvizjes VV, Visar Ymerit dhe Aida Dërguti, nga njësitet policore i ishte kërkuar që të jenë prezent gjatë kontrollit por të njëjtit kishin refuzuar një gjë të tillë<sup>23</sup>. Në ora 20:05 nga Drejtori i

---

<sup>18</sup> Video-incizimet siguruara nga media.

<sup>19</sup> Raport Pas Operacional DDO / 04-128/2015.

<sup>20</sup> Intervista me zyrtarët policor të përfshirë në plan Operativ.

<sup>21</sup> Logu i DPP-së Datë: 28.11.2015/ Logu i DH- DPP Datë: 28.11.2015 ;

<sup>22</sup> Plani Operativ "28 Nëntori" Ref. 04/1-01 SOR/064/2015;

<sup>23</sup> Raporti Pas Operacional Ref. DHH/06/222/2015;

Departamentit të Hetimeve është dhënë informata se ka përfunduar shikimi i vendit të ngjarjes në selinë e LVV.<sup>24</sup>

3.2.17 Ndërsa sa i përket personave të arrestuar me 28 nëntor 2015, brenda hapësirave të Stacionit Policor Qendra, intervistimi dhe vazhdimi i procedurave hetimore ndaj tyre është zhvilluar nga njësitet e hetuesisë në koordinim me zyrën e prokurorit të shtetit. Procedura e hetimit dhe intervistimi i personave të arrestuar ishte bërë nga njësitet e hetuesisë në kuadër të Stacionit Policor Qendra dhe ekipi i hetuesisë në nivel të Hetuesisë Regjionale në Prishtinë. Në bazë të informacioneve të intervistave më zyrtaret policor kompetent, rastet e personave të arrestuar për të cilët ka pasur dyshime se janë përfshirë në veprime penale janë marrë në trajtimin nga ana e ekipit hetuesisë regjionale, ndërsa rastet tjera të dyshuar për veprime më të lehta dhe kundërvajtje janë trajtuar nga ana e njësisë së hetimeve të Stacionit Policor Qendra. Procedura e intervistimit të të gjithë personave të arrestuar ka zgjatur përafërsisht deri në orën 21 të mbrëmjes së asaj dite.<sup>25</sup>

3.2.18 Pas përfundimit të Operacionit dhe normalizimit të situatës në kryeqytet në orën 23:03 me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Operacionit mbyllet Dhoma Komanduese në nivelin e DPP-së ndërsa Dhoma komanduese në nivel të DRP- Prishtina ka vazhduar të jetë e hapur deri në mëngjesin e datës 29.11.2015.<sup>26</sup>

### **3.3. Aktivitetet policore pas manifestimit/protestës së 28 Nëntorit 2015**

3.3.1 Në ditët pasuese të datës së 28.11.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria Rajonale e Policisë Prishtinë, Departamenti i Hetimeve i DPP-së si dhe Njësitë e Specializuara të angazhuara në plan operativ, kanë përpiluar Raportet Pas Operacionale në të cilat specifikisht dhe në mënyrë kronologjike kanë përshkruar të dhënat dhe rrjedhën e mbarëvajtjes së ngjarjes si dhe menaxhimin e situatës nga ana e PK-së me datën 28 nëntor 2015. Vlen të theksohet që në Raportet Pas Operacionale, janë potencuar konkludime dhe rekomandime që kanë dal si rezultat i tërë ngjarjes që është zhvilluar ditën e protestës së 28 nëntorit 2015.

3.3.2 Në bazë të Raportit Pos-Operacional të Urdhrit operativ “28 nëntorit 2015” nr. Referencës DDO/04-128/2015 të hartuar nga ana e Departamentit për Operacione të DPP-së, në manifestimin e datës 28 nëntor 2015 në Sheshin “Zahir Pajaziti është vlerësuar së kanë marr pjesë rreth 4500 qytetarë protestues. Për menaxhimin e situatës gjatë rrjedhës së protestës dhe pas saj Policia e Kosovës kishte të angazhuar gjithsejtë 2068 zyrtarë policor.<sup>27</sup> dhe atë nga këto njësi:

- Polic të rendit publik;
- Polic të trafikut;
- NJRSH;
- Togjet rezervë
- NJSO;
- NJSI;
- Hetimet/Inteligjencën në nivel Qendrorë dhe Lokal;
- Shërbimet shëndetësore;

---

<sup>24</sup> Logu i DPP-së Datë: 28.11.2015;

<sup>25</sup> Intervista me zyrtaret policor të njësisë të hetimeve DRP-Prishtinë;

<sup>26</sup> Logu i DPP-së Datë: 28.11.2015/<sup>26</sup> Logu i DRP-së Datë: 28.11.2015;

<sup>27</sup> Raporti Pas Operacional Ref: DDO/04-128/2015;

3.3.3 Referuar raporteve Pas Operacionale, operacioni policor ishte zhvilluar sipas planifikimeve operacionale dhe rrjedhojës së zhvillimit të situatës së sigurisë në përgjithësi dhe PK-ja ka ndërmarrë veprime e duhura policore gjatë implementimit të Urdhrit Operativ "28 nëntorit 2015". Në bazë të raporteve Pas Operacionale dhe në bazë të të gjitha të dhënave operacioni i Urdhrit Operativ "28 nëntorit 2015", ishte implementuar në ditën konkrete si dhe janë përmbushur dhe realizuar qëllimet dhe objektivat e PK-së. Në ditën konkrete PK-ja kishte zbatuar edhe Urdhrin Operativ "Zbatimi i Urdhërësave të Gjykatave" dhe Urdhrin Operativ "Zbatimi i Urdhrave të ligjshëm të organeve kompetente".

3.3.4 Gjatë realizimit të Urdhërësës së Gjykatës për arrestim të personit me Urdhër Arrest, me datën 28.11.2015, (5) pjesëtarë të PK-së ishin lënduar si dhe dhjetë (10) aktivist të LVV të cilët kanë marrë ndihmën mjekësore. Po atë ditë në stacion policor janë shoqëruar 97 persona, prej tyre 11 janë ndaluar për 48 orë me dyshime për përfshirje në vepra penale, 53 janë dërguar në procedurë të shpejtë për përfshirje në raste kundërvajtje, 26 janë liruar në procedurë të rregullt, si dhe 7 të mitur janë liruar<sup>28</sup>.

3.3.5 Po ashtu si pjesë e vazhdimit të detyrave policore, në koordinim me prokurorin e shtetit, në objektin e selisë së VV-së, nga njësitë i Teknikës Kriminalistike të PK-së, është realizuar edhe këqyrja e vendit të ngjarjes, ku në cilësi të provave materiale janë konfiskuar<sup>29</sup>:

- 2- cipë gazë maska ushtarake;
- 1-sprej (OC) i vogël;
- 2- shufra metalike;
- 2-mjete të destinuara për gjuajtje të sferave me 1lastika;
- 4-qese me sfera xhami;
- 1-gaz lotsjellës;
- 3-radiolidhje motorolla;
- 1-shishe me sasi ½ litrës me plumba gome-26 copë;
- 1-fishekzjarrë me barot;
- 3-boca gazi lotsjellës të zbrazëta;
- 1-qese najloni me 7 copa gaz lotsjellës;
- 1-qese me sfera me ngjyrë;
- 1-çantë me tri shishe plastike me sasi ½ litrës të mbushura me benzinë;
- 1-shishe plastike prej 1.5 litra benzinë;
- 1-sprej i vogël OC djegës;
- 1-sprej i vogël OC djegës;
- 2-qese me armatura të salduara në formë iriqi për shpim të gomave të veturave;
- 5 shishe në sasi prej 1.5 litra të mbushura me ngjyrë pink;
- 13-copë maska të zeza (fantomka) për mbulim të fytyrës;

3.3.6 Departamenti për hetimet e Krimin në Kuadër të DPP-së me datën 03.12.2015, ka përpiluar Raportin e Vlerësimit Pas-Operacional Ref. DHH/06/222/2015, për angazhimin policor të njësiteve policore të këtij departamenti si dhe të gjitha ekipeve hetimore që kanë mbështetur aktivitetin policor më datën 28 nëntor 2015.

3.3.7 Po ashtu pas përfundimit të operacionit të datës 28 nëntor udhëheqësit e njësiteve të specializuara që kanë qenë pjesë e angazhimit operacional sipas planit operativ kanë

<sup>28</sup> Raporti Pas Operacional Ref DDO/04-128/2015

<sup>29</sup> Raporti Pas Operacional Ref DDO/04-128/2015; Raporti i Këqyrjes së Vendit të ngjarjes (DTK);

përpiluar shkresat shënime të zyrtare lidhur me kronologjinë e ngjarjeve dhe aktivitetin policor që kanë pasur njësitet e tyre atë ditë. Por gjatë inspektimit ekipi i IPK-së kishte kërkuar edhe nga secili komandant taktik i angazhuar në operacionin policor të 28 nëntorit raportet pas operacionale, mirëpo një numër i tyre nuk kishin përpiluar fare raporte me arsyetimin se nëpër pikat ku ata kanë qenë në detyrë situata ka qenë e qetë dhe se fare nuk a kanë pasur ndonjë ballafaqim me protestues.

3.3.8 Sipas shënimit zyrtarë të datës 07 dhjetor 2015, Udhëheqësi i Njesisë Speciale Operative NJSO njofton se me datën 28 nëntor 2015, kjo njësi konform planit operativ të hartuar nga ana e DNJS, ka pasur (3) Tri togje nga Prishtina dhe një tog nga Mitrovica. Kjo njësi që nga fillimi i operacionit deri në orën 15:40 kishte qëndruar në gjendje gatishmërie për shkak se s'kishte arsye për intervenim dhe angazhim ngase rrjedha e manifestimit kishte vajtur qetë deri në fund kur ishte shfaqur deputeti A. Kurti, ndaj të cilit kishte Urdhër Arrest nga gjykata. Ndërsa sipas shënimit zyrtarë të datës 30 nëntor 2015, Udhëheqësi i Njesisë Speciale Intervenuese (NJSI), konform planit operativ "Manifestimi 28 nëntorit," kishte angazhuar nga kjo njësi gjithsej 44 operator në detyrë.

#### **4. VLERËSIMI I RESPEKTIMIT TË INFRASTRUKTURËS LIGJORE NË MENAXHIMIN E SITUATËS GJATË MANIFESTIMIT TË DATËS 28.11.2015**

---

4.1 Policia e Kosovës, në kuadër të angazhimeve të saja dhe përgatitjeve me rastin e protestës ka pasur parasysh dokumentacionet të cilat kanë qenë bazë përmes së cilave ka bërë përgatitjet për të menaxhuar në mënyrën e duhur situatat dhe nevojat e caktuara të cilat do të mund të paraqiteshin gjatë manifestimit (protestës). Këto dokumentacione rrjedhimisht janë: Ligji i Policisë së Kosovës Nr. 046/L-076, Udhëzimet Administrative, Procedurat Standarde të Operimit, si dhe Udhëzuesi për Hartimin e Urdhrave dhe Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore.

4.2 Policia e Kosovës, dokument bazë për përgatitjen në të gjitha nivelet e organizimit policor (qendror, rajonal, lokal) ka pasur Udhëzuesin për Hartimin e Urdhrave dhe Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore i hartuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Operacional.<sup>30</sup> Ky udhëzues ka për qëllim kryesor që përmes udhëzimeve të caktuara të ofrojë përshkrime të shkurta në lidhje me përmbajtjen e planeve dhe urdhrave operativ, përcakton procedurën e cila parasheh angazhimet dhe rrethanat për secilin nivel organizativ policor, modelin e urdhrit/planit operativ i cili përmban pesë pikë me elemente siç janë (informata, qëllimi, metoda, administrimi dhe komunikimi) të cilat në veçanti janë të precizuara në shtojcën A të këtij udhëzuesi.

4.3 Përgatitjes së të gjitha dokumentacioneve i ka paraprirë Raporti Analitik “Vlerësimi i Situatës së Sigurisë me rastin e festës kombëtare të ditës së flamurit 28 Nëntori-Protesta Paqësore të Bllokut Opozitar ” e përpiluar nga Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës pranë DPP me datë 23.11.2015, sipas të cilit raport niveli i vlerësimit të rrezikshmërisë është përcaktuar Mesatar-Lartë, i cili vlerësim ka vlejtur vetëm për lokacionin e përcaktuar se ku do të mbahej protesta (manifestimi), deri sa për rajonet tjera në Republikën e Kosovës vlerësimi i rrezikut është përcaktuar i nivelit Mesatar. Vlen të theksohet që raporti ka përfshi se vlerësimi nuk është përfundimtar dhe se për të gjitha informacionet që arrijnë në ndërkohë do të njoftohen me kohë<sup>31</sup>.

4.4 Lidhur me protestën (manifestimi) e paralajmëruar përmes medieve, PK-ja konkretisht Drejtori i Departamentit për Operacione në respektim të vijës strukturore kishte lëshuar Urdhrin Operativ “28 Nëntori 2015” me datë 25.11.2015 dhe nr. Reference DDO 04-128-2015, i cili urdhër ka përfshi pesë pikëshin nga modeli i urdhrit/planit operativ, duke pasqyruar në mënyrë të përgjithshme përgjegjësitë të cilat do të paraqiteshin gjatë operacionit duke lënë në përgjegjësi të niveleve më të ulëta që të përmbajnë informacione të hollësishme në lidhje me detyrat e caktuara dhe masat që duhet ndërmarrë për të siguruar një përfundim të suksesshëm të operacionit të planifikuar ashtu siç edhe parasheh udhëzuesi për hartimin e urdhrave/planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policore.

4.5 Urdhri Operativ i DPP, në pikën referuese tek metoda përveç që ka përfshi në angazhime të gjitha Drejtoritë Rajonale Policore, për shkak se protesta (manifestimi) është paraparë që të mbahet në zonë të përgjegjësisë së DRP-Prishtinë, ky urdhër operativ në pikë të veçantë ka paraparë Drejtorinë Rajonale Policore Prishtinë e cila drejtori ka nxjerrë Plan Operativ Manifestim – 28 Nëntori 2015, me datë 26.11.2015 dhe nr. Reference 04/1-01 SOR/064/2015.

---

<sup>30</sup> Departamenti Për Operacione/Udhëzuesi “Hartimi i Urdhrave/ Planeve Operative dhe menaxhimi i Operacioneve Policore/Ref. DDO-04/1-08/010-2014;

<sup>31</sup> Raport Analitik/“Vlerësimi i Situatës së Sigurisë më rastin e Festës Kombëtare të Ditës së flamurit 28 nëntor-Protesta Paqësore të bllokut Opozitar/Datë:23/11/2015/DIA#60689;

Ky Plan Operativ ka përfshi të gjithë modelin pesë pikësh të udhëzuesit për hartimin e urdhrave dhe planeve operative por që disa të dhëna tek pika Administrimi janë shënuar në pikën Metoda (shërbimet mjekësore, zjarrfikësit, transporti i të arrestuarve si dhe nuk janë shënuar detajet për ndërlikohje dhe pika kontaktuese të agjencive jashtë policore, furnizimet (skica, harta plane) duke mos respektuar në përpikëri çështjet e precizuara në Shtojcën A të udhëzuesit për hartimin e urdhrave/planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policor<sup>32</sup>.

4.6 Po ashtu Departamenti i Hetimeve, në përputhje me Urdhrin Operativ të lëshuar nga DPP, kishte përpiluar Planin Operativ "28 Nëntori" i cili ka përfshi modelin pesë pikësh të udhëzuesit për hartimin e urdhrave operativ dhe planeve operative, por që ka pasur çështje tek pika Administrimi siç janë: koha, data, vendi i takimit informativ, para dhe pas operacionit/brifingu-debrifingu, caktimi i një afati të arsyeshëm për dorëzimin e planeve/urdhrave operativ/raporteve pas operacioneve duke përfshi këtu dhe kompletimin e planeve/urdhrave operativ vartës (të nivelit më të ultë), burimet materiale (pajisje speciale, jelekët antiplumb lokacionet e paraqitjes së stafit para fillimit të detyrës dhe pas përfundimit të saj, shërbimet dhe përkrahja, logjistika (ushqimi, uji, karburantet, etj), pushimi, akomodimi,<sup>33</sup> të cilat nuk janë shënuar në pikën Administrimi ashtu siç parasheh udhëzuesi për hartimin e urdhrave/planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policore duke bërë që Shtojca A e këtij udhëzuesi të mos përfillet në plotësi.

4.7 Në respektim të urdhrin operativ të lëshuar nga DPP, Divizioni për Njësi të Specializuara kishte përpiluar Plan Operativ "28 Nëntori" me datë 26.11.2015<sup>34</sup>, i cili plan ka përfshi pesë pikëshin e përcaktuar në Udhëzuesin për Hartimin e Urdhrave dhe Planeve Operative, duke precizuar strukturën komanduese me emra dhe pozita, por që disa nga çështjet e përcaktuara në pikën Administrimi (burimet e gatshme njerëzore dhe materiale- pajisje speciale, jelekët antiplumb, caktimi i një afati të arsyeshëm për dorëzimin e planeve/urdhrave operativ/urdhrave operativ vartës (të nivelit më të ultë) kanë bërë që kërkesat e përcaktuara në Shtojcën A të këtij udhëzuesi të mos respektohen në përpikëri.

4.8 Duhet theksuar që Policia e Kosovës në vazhden e aktiviteteve të saj të përditshme ka përpiluar shkresa të cilat janë paraqitur si nevojë e situatës së krijuar në rrethanën kur Gjykata Themelore në Prishtinë konkretisht Departamenti për Krime të Rënda kishte lëshuar Urdhër-Arrest ndaj dy deputetëve<sup>35</sup> me ç'rast PK me datë 17.11.2015, kanë lëshuar dy urdhra operativ "Zbatimi i Urdhëresave të Gjykatës"<sup>36</sup> dhe "Zbatimi i Urdhëresave të Ligjshëm të organeve kompetente"<sup>37</sup> Këto dy urdhra operativ për PK-së kanë qenë aktiv deri në momentin kur do të realizohej Urdhër Arresti<sup>38</sup> i lëshuar nga gjykata kompetente me qëllim të zbatimit të obligimeve ligjore.

4.9 Për më tutje, Urdhrat Operativ "Zbatimi i Urdhëresave të Gjykatës", dhe "Zbatimi i Urdhëresave të Ligjshëm të organeve kompetente" pikë referuese për përpilimin e tyre kanë pasur udhëzuesin për hartimin e urdhrave dhe planeve operative dhe menaxhimin e

---

<sup>32</sup> *Plani Operativ Manifestim-28 Nëntori 2015 DRP-Prishtinë, Udhëzuesi për Hartimin e Urdhrave/Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore Ref: DDO-04/I-08/010-2014*

<sup>33</sup> *Departamenti i Hetimeve/Plani Operativ "28 Nëntori" Ref: DDH/06/222/2015*

<sup>34</sup> *Divizioni i Njësiteve të Specializuara/ Plani operativ "28 Nëntori" Ref: 04-02/OPS939/2015;*

<sup>35</sup> *Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda/Urdhër Arrest/PPRKR. Nr. 413/15;*

<sup>36</sup> *Urdhri Operativ "Zbatimi i Urdhëresave të Gjykatës Datë 17.11.2015/ Ref: DDO 04-124-2015;*

<sup>37</sup> *Urdhri Operativ "Zbatimi i Urdhrave të Ligjshëm të organeve kompetente /Datë: 17.11.2015/Ref: DDO 04-125-2015;*

<sup>38</sup> *Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda/Urdhër Arrest/ PPRKR. Nr. 413/15;*

operacioneve policore të cilat kanë përmbajtur pesë pikëshin nga shtojca A e udhëzuesit<sup>39</sup> me elementet si informata, qëllimi metoda, administrimi dhe komunikimi. Vlen të theksohet që tek pika informata të dy urdhrat operativ përveç tjerash kanë potencuar që niveli i rrezikshmërisë të jetë Mesatar-Lartë. Ndërsa shënimi për caktimin e Udhëheqësit të Përgjithshëm të Operacionit Policor nuk është në përputhshmëri me udhëzuesin për shkak se në urdhrat operativ të datës 17.11.2015, kjo çështje është shënuar në paragrafin e pikës 1. Informata me renditjen 1. a deri sa udhëzuesi parasheh se kjo duhet të shënohet në renditjen 1. b<sup>40</sup>.

4.10 Andaj, referuar ngjarjes së ndodhur me datën 28.11.2015, PK përveç planifikimeve dhe organizimit për të siguruar mbarëvajtjen e manifestimit (protestës), në përputhje me ngjarjen e paraqitur (paraqitja e deputetit A. Kurti ndaj të cilit Gjykata Themelore në Prishtinë kishte lëshuar Urdhër Arrest) ka vazhduar angazhimet në realizimin e urdhrave operativ të lartcekur që kanë dal si rezultat i zbatimit të Urdhër-Arrestit të lëshuar nga gjykata kompetente, dhe të cilin konkretisht e ka realizuar Njësia Speciale Intervenuese e Policisë së Kosovës.

4.11 Dokumente në të cilat janë të përcaktuara detyrat dhe autorizimet e NJSI-së, janë Udhëzimi Administrativ 02/2012, për Përdorim të Forcës nga Zyrtarët Policorë si dhe Procedura Standarde e Operimit me nr. Referencë NJSI/PSO/001/11. Udhëzimi Administrativ 02/2012, përcakton rregullat lidhur me përdorimin e forcës fizike nga ana e zyrtarëve policor ndaj personave apo qytetarëve dhe shqyrtimin e përdorimit të forcës në të cilin udhëzim nga neni 18, deri në nenin 20 në mënyrë të veçantë janë të përcaktuara organizimi dhe funksionimi i Njesisë Speciale Intervenuese, detyrat dhe autorizimet e Njesisë Speciale Intervenuese si dhe uniforma e Njesisë Speciale Intervenuese.

4.12 Sipas këtij udhëzimi, konkretisht nenit 18, angazhimi Njesisë Speciale Operative bëhet me urdhër të drejtpërdrejtë të drejtorit të Departamentit për Operacione, deri sa autoritet i vetëm miratues për angazhim operacional i Njesisë Speciale është Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Ndërsa referuar Procedurës Standarde të Operimit për Njësiti Speciale Intervenuese kjo njësi operativisht angazhohet nga Ndhmës Drejtori i Përgjithshëm për Operativë ( i cili sipas strukturës së re organizative të Policisë së Kosovës është i emërtuar si Drejtori i Departamentit për Operacione), me të cilin rrethanë këto dy dokumente nuk janë të harmonizuara njëra me tjetrën.

4.13 Ndërsa sa i përket detyrave dhe autorizimeve të Njesisë Speciale Intervenuese, neni 19 i Udhëzimit Administrativ Për Përdorimin e Forcës nga Zyrtaret Policor, ka përcaktuar këto detyra dhe autorizime në pesë paragrafë të cilat përfshijnë **por nuk kufizohen vetëm në:**

- 1.1 ofrimin e mbështetjes në kryerjen e detyrave për zgjidhjen e situatave apo rrethanave të veçanta si lirim apo shpëtimin e pengjeve, zgjidhjen e situatave të kidnapimit të personave, me rastin e plaçkitjes së armatosur, rastet e rënda të prishjes apo rivendosjes së rendit dhe sigurisë publike, arrestimin e personave të armatosur dhe grupeve kriminale, transportimin e personave me rrezikshmëri të lartë- ndërhyrjen në raste të rebelimit të të burgosurve , përcjelljen dhe sigurimin e personaliteteve të ndryshme në situata të veçanta.

---

<sup>39</sup> Departamenti Për Operacione/Udhëzuesi "Hartimi i Urdhrave/ Planeve Operative dhe menaxhimi i Operacioneve Policore/Ref. DDO-04/1-08/010-2014;

<sup>40</sup> Urdhër Operativ "Zbatimi i Urdhrave të Ligjshëm të organeve kompetente" Ref. DDO 04-125-2015, Urdhër Operativ "Zbatimi i Urdhëresave të Gjykatës" Ref. DDO 04-124-201



- 1.2 Ofrimin e ndihmës populatës së rrezikuar në raste të fatkeqësive natyrore apo aksidenteve të rënda kur kemi të bëjmë me shpëtim jetës.
- 1.3 Ruajtjen e objekteve me rëndësi vitale, ku ka të dhëna për sulme me armë apo mjete shpërthyes, ndërsa njësitet e rregullta nuk janë në gjendje që ti siguroj këto objekte.
- 1.4 Përkrahjen apo ndihmën e ofruar njësisë për mbrojtjen e afërt, njësiteve mbështetëse rajonale dhe njësiteve kundër krimit të organizuar, kur përballen apo sulmohen me armë të zjarrit
- 1.5 Rrethanat kur Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës vlerëson se një gjë e tillë është e domosdoshme.

4.14 Siç është potencuar dhe më lartë detyrat dhe autorizimet e kësaj njësie janë të përcaktuara dhe në PSO në të cilën është e precizuar se NJSI është e përgatitur që të ndërtojë në operacionet e rrezikshmërisë së lartë apo ekstreme por që **detyrat nuk janë të kufizuara vetëm në detyrat e përcaktuara në dymbëdhjetë pika të PSO-ës.**

4.15 Kështu që dy dokumentet si udhëzimi administrativ ashtu dhe procedura standarde e operimit për NJSI-se, parasheh se detyrat dhe autorizimet e kësaj njësie nuk janë të kufizuara vetëm në detyra specifike të caktuara, me ç'rast vendimi i PK-së për angazhimin e kësaj njësie me datën 28.11.2015, nuk ka përbërë ndonjë kufizim ligjor.

4.16 Si rrjedhojë e ngjarjes Policia e Kosovës, kishte vazhduar angazhimin e saj dhe me rastin e realizimit të Urdhër Arrestit PPRKR .nr. 413/15, duke arrestuar njërin nga të pandehurit e potencuar në këtë dokument kishin hy në objektin e Lëvizjes "Vetëvendosje". Hyrja në objektin e Vetëvendosjes është bërë në kuptim të nenit 110, "Arsyet për kontroll pa urdhër të gjykatës", paragrafi 1, pika 1.5, të KPPK-së, sipas të cilit kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, zyrtarët policor mund të hyjnë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojnë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse: personi kundër të cilit është lëshuar Urdhër Arrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo lokale të tjera. Kështu që në këtë situatë Policia e Kosovës ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore.

4.17 Si rezultat i realizimit të Urdhër Arrestit PPRKR .nr. 413/15, PK-së në objektin e Lëvizjes Vetëvendosje kishin hasur në gjësende të cilat janë dyshuar të jenë të kundërligjshme dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje kishin informuar prokurorin kompetent të çështjes dhe gjyqtarin kujdestar të procedurës paraprake. Referuar raportit pas operacional të PK-së, konkretisht të Departamentit për Hetime pas udhëzimit nga prokurorët kompetent për të filluar me kontroll, Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda së bashku me zyrtarët e Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike kishin ndërmarrë veprime me të cilat kishin sekuestruar gjësende të dyshimta të cilin veprim e ka bërë në përputhje me nenin 110, paragrafi 5, i KPPK-së dhe për të cilën gjë kishin hapur rast penal me nr. 2015-DKR-040 "Armëmbajtje pa Leje."<sup>41</sup> Mirëpo, në kuptim të nenin 110, paragrafi 6, "Arsyet për kontroll pa urdhër të gjykatës", kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) orësh pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës, gjë për të cilën PK-së, bashkangjitur me rastin ka dorëzuar raport prokurorit kompetent por

<sup>41</sup> Drejtoria e Teknikës Kriminalistike Nr. dosjes së DTK-së 2015-DTK-080-VN;

që nuk ka prezantuar inspektorëve ndonjë raport të cilin ia ka dërguar gjyqtarit kompetent në mënyrë që më pastaj të merr aprovimin retroaktiv gjyqësor të kontrollit.

4.18 Për më tutje, Policia e Kosovës gjatë realizimit të operacionit ka arrestuar disa persona për të cilën gjë zyrtarët policor të cilët kanë përdorur forcën, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 02/2012, për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor, nenin 21, Raportimi, kanë plotësuar formularët e përdorimit të forcës. Si rrjedhojë e kësaj Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës Fizike për të gjitha rastet ka marr vendim ku përdorimi i forcës fizike nga ana e zyrtarëve policor ka qenë në përputhje me Ligjin e Policisë dhe Udhëzimin Administrativ për Përdorimin e Forcës Fizike. Vlen të theksohet që referuar vendimeve të Komisionit për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës Fizike formularin e kanë plotësuar dhjetë (10) zyrtarë policor e të cilat kanë pasur të bëjnë me përdorimin e forcës: Forca Fizike, Shufra dhe Sprej OC<sup>42</sup>.

---

<sup>42</sup> *Vendimet e Komisionet për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës Fizike*

## 5. VLERËSIMI I RESPEKTIMIT TË RREGULLAVE LIGJORE PËR PËRDORIMIN E FORCËS NGA ZYRTARËT POLICOR

---

5.1 Pas pranimit të Urdhër Arrestit me nr. PPRKR. nr. 413/15, lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës Themelore të Prishtinës , me datën 17.11.2015 Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Renda (DHKR) është autorizuar për ta ekzekutuar këtë Urdhër Arrest ndaj të pandehurit Albin Kurti. DHKR kishte bërë përpjekje për lokalizimin e vendndodhjes së personit në fjalë me qëllim të realizimit të Urdhër Arrestit por i njëjti ishte fshehur nga policia dhe nuk ishte hasur nga policia deri me datën e 28 nëntorit 2015 në manifestimin e organizuar nga partitë opozitare. Lidhur me këtë situatë ishte informuar Prokurori i Rastit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Po ashtu është njoftuar edhe Gjyqtari Kujdestar i Procedurës Paraprake.

5.2 Në këtë kohë nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm për Operacione (DDO) nga të gjitha njësitë në operacion kishte kërkuar që të ndërmerren veprime konkrete. Pas këtij urdhri të dhënë nga ana e DDO-së, Komandanti Taktik (fushor) në terren nga ana e NJSO me shifrën AW gjatë komunikimit me Udhëheqësin e Dhomës Komanduese në DPP (DDO) kishte pranuar kërkesën për krijimin e kushteve dhe mundësive që NJSI të futet në objektin e selisë së LVV<sup>43</sup>. NJSO menjëherë kishte vepruar për realizimin e kësaj urdhërese mirëpo kishte hasë në rezistencë aktive fizike<sup>44</sup> nga ana e protestuesve ku një pjesë e tyre ishin futur brenda selisë dhe ishin barrikaduar. Gjatë këtij intervenimi policor ishte përdorur forca fizike me shufra gome, mburoja dhe sprej OC<sup>45</sup>.

5.3 Me autorizim dhe urdhër të Dhomës Komanduese të DPP-së, rreth orës 15:40 minuta është kërkuar nga Udhëheqësi i NJSI-së që të bëhen të gjitha përgatitjet e nevojshme në koordinim me NJSO-në dhe Hetimet të ndërmerren në selinë e VV-së me qëllim të kapjes dhe arrestimit të të kërkuarit A. Kurti. NJSI, të përcjellur nga ekipet e hetimeve, rreth orës 15:52 kishte filluar intervenimin në objektin e selisë së LVV-së.<sup>46</sup>

5.4 Ngjarja e krijuar, numri i protestuesve të cilët kishin bllokuar hyrjen para objektit të selisë së LVV-së, informacioni i saktë që personi i cili është kërkuar me Urdhër Arrest nga Gjykata, si dhe mungesa e informacioneve për identitetin e individëve të cilët janë konsideruar në numër të bollshëm brenda objektit ku do të operohej, kishin bërë që udhëheqësit e dhomës komanduese të angazhojnë Njësinë Speciale Intervenuese e cila njësi është e trajnuar për të intervenuar -ndërhyj në rastet kur rreziku është i nivelit tejet të lartë.

5.5 Sapo NJSI ishte ofruar për intervenim tek porta e selisë së VV-së, porta kishte qenë e mbyllur me qesë dhe prapa xhamave vëreheshin aktivistë të cilët tentonin me trup të siguronin derën që të hapej. Nga pamundësia e hapjes normale të portës, NJSI kishte bërë hapjen me forcë duke thyer xhamin e sajë dhe kishte avancuar brenda. Sipas raporteve operacionale të PK-së, me tu futur brenda, njësitë policore kishin hasur në rezistencë të vazhdueshme aktive nga kati përdhes i ndërtesës së selisë së LVV-së, të cilët tentonin të pengonin avancimin e njërive për në katet e mësipërme të ndërtesës prej 5 katesh.<sup>47</sup>

---

<sup>43</sup> Shënim Zyrtar NJSO datë 02.12.2015

<sup>44</sup> Udhëzimi Administrativ 02/2012 Për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor/ Rezistenca Aktive nënkupton kur personi fizikisht ju reziston tentimeve të zyrtarit policor për ta vënë nën kontroll, nëpërmjet veprimeve të drejtpërdrejta fizike.

<sup>45</sup> Raporti Pas Operacional I DPP-së Ref. DDO-04-128/2015; Raportit mbi Përdorimin e Forcës/Komisioni për shqyrtimin e Përdorimit të Forcës;

<sup>46</sup> Raporti Njoftues nga NJSI Ref. 04/2-604/2015;

<sup>47</sup> Raporti Njoftues nga NJSI Ref. 04/2-604/2015;

5.6 Referuar raportit pas operacional të NJSI-së, rezistenca aktive e një numri të aktivisteve kishte vazhduar, duke hedhur në drejtim të njërive policore shtiza, copa druri, orendi, karrige, dollap apo komodina si dhe në katin e tretë dikush nga ana e aktivisteve kishte hedhur edhe gaz lotsjellës ku kishte detyruar të vendosin gaz maskat dhe kishin avancuar deri në katin me të lartë në kërkim të personave të kërkuar. Në katin me të lartë në shënim theksohet se disa nga hapësirat kanë qenë të mbyllura të cilat NJSI i ka hapur me forcë. Ndërsa në katin e pestë në një dhomë (kantinë) është gjendur i kërkuari deputeti A. Kurti i shoqëruar nga persona tjerë që për afërsisht kishin qenë dhjetë (10). Gjatë arrestimit deputeti A. Kurti nuk kishte rezistuar përderisa personat e tjerë në dhomë kanë ushtruar rezistencë dhe ndaj të cilëve NJSI kishte vepruar, duke i vënë nën kontroll dhe të gjithë ishin shoqëruar poshtë tek njësitet e hetuesisë. Të gjithë personat e arrestuar janë përcjellë kujdesshëm deri në katin e përdhësë për t'ju dorëzuar tek njësitet tjera policore për transportin e tyre te stacioni policor<sup>48</sup>.

5.7 Gjatë tërë kohës sa NJSI ka qenë në veprim brenda selisë së VV-së, NJSO me ekipet e saj kanë kryer sigurimin e perimetrit të parë të sigurisë dhe ka ndihmuar njësitet përgjegjëse për shoqërimin dhe transportimin e personave të arrestuar, si dhe ofrimin e ndihmës mjekësore për personat e lënduar gjatë ballafaqimit me intervenimin policor. Po ashtu në koordinim me Dhomen Komanduese të DPP-së, NJSO me automjete të blinduara ka realizuar transportin e deputetit të arrestuar A. Kurti fillimisht për në Gjykatë tek Pallati i Drejtësisë e më pas në burgun e sigurisë së lartë në Dyz.<sup>49</sup>

5.8 Sipas procedurave dhe rregullave që dalin nga Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 Për Përdorimin e Forcës, neni 21, nga ana e zyrtarëve policor, është e paraparë që të gjithë zyrtarët policor që kanë përdorur cilën do lloj të forcës, në përputhje me bazën ligjore të raportojnë përdorimin e forcës duke plotësuar formularët për përdorimin e forcës e më pastaj në respektim të çështjeve procedurale t'i përcjellin përmes zinxhirit komandues, për trajtime të mëtejme pranë Komisionit për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës.

5.9 Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë është angazhuar për të trajtuar të gjitha rastet e raportuara të përdorimit të forcës, pas ngjarjes së 28 nëntorit 2015, ka pranuar 10 raste të raportit të përdorimit të forcës nga zyrtarët policore të njërive të përfshira në operacionin e asaj dite. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve ka nxjerrë vendimet mbi arsyeshmërin e përdorimit të forcës së arsyeshme dhe proporcionale në pajtim me ligjin dhe rregullat tjera në fuqi<sup>50</sup>.

5.10 Vlen të cekët se IPK-së konkretisht DH me kërkesë të Prokurorit ka siguruar serverin e Video-incizimeve i cili nuk është hapur për shkak se zyrtarët e Lëvizjes Vetëvendosjes nuk kanë pranuar që të japin kodin (passwordin) për tu qasur në ato incizime, të cilat do të jepnin pasqyrim të saktë të ngjarjes, dhe në bazë të së cilës do të dilnin konkludimet lidhur me nivelin e përdorimit të forcës nga ana e zyrtarëve policor.

---

<sup>48</sup> Raporti Pas Operacional i

DPP-së Ref. DDO-04-128/2015 Raporti Njoftues nga NJSI Ref. 04/2-604/2015;

<sup>49</sup> Shënim i zyrtar nga Komandant i NJSO-së /Raporti kronologjik lidhur me angazhimin e NJSO-së në implementimin e planit Operativ "28 nëntor2015/ datë: 07.12.2015"

<sup>50</sup> Vendimet e Komisionit për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës fizike;

## 6. PËRFUNDIMET

---

6.1 Më të marrë informacionin për organizimin e manifestimi/proteste nga partitë opozitare si dhe duke u bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të situatës së krijuar shoqërore e politike si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit në vend, Policia e Kosovës në saje të autorizimeve dhe detyrave policore që burojnë nga ligji ka ndërmarrë veprimet përgatitore planifikuese për menaxhimin e situatës dhe ofrimin të sigurisë, rendit dhe qetësisë publike. Pra ishte bërë vlerësimi i situatës së sigurisë, ishte hartuar Urdhri Operativ nga DPP-ja si dhe ishte hartuar Plani Operativ nga DRP-ja. Në saje të këtyre përgatitjeve policore ishin paraparë edhe struktura dhe njësitet policore të cilat do të përfshihen në këtë operacion.

6.2 Për implementimin e urdhrin dhe planit operativ, menaxhimit dhe mbajtjes nën kontroll të situatës gjatë ngjarjeve të datës 28 nëntor 2015, duke filluar nga ora 10:00 ishin hapur Dhomat e Komandimit në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së, Departamenti i Hetimeve të DPP-së, DRP-Prishtinë. Ndërsa Drejtoritë tjera Regjionale të PK-së kishin hapur Dhomat e Komandimit për qëllim të veprimeve dhe koordinimit më të mirë operacionel. Në të tri dhomat e komandimit gjatë rrjedhës së aktivitetit policore dhe gjithë ngjarjes së ditës janë mbajtur edhe logjet e ngjarjes. IPK-ja gjatë analizimit të këtyre shënimeve në logjet e dhomave të komandimit vërehet se ka mungesë të përfshirjes së shumë informatave të rëndësishme që përshkruajnë ngjarjen dhe aktivitetin e komunikimit policor nëpërmes radiolidhjeve, të cilat kanë ardhur si rezultat i komunikimit telefonik në mes të strukturave policore të angazhuar në operacion. Ky komunikim i cili sipas Udhëzuesit për Hartimin e Urdhrave dhe Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore mund të realizohet vetëm kur nuk ka alternativë tjetër.

6.3 Zhvillimi i ngjarjes gjatë aktivitetit protestues në sheshin "Zahir Pajaziti", mbajtjes së fjalimeve, e deri tek shpallja e përfunduar e protestës nga ana e organizatoreve të sajë, ngjarja ka pasur rrjedhë të qetë dhe normale. Gjatë rrjedhës së mbajtjes së protestës së qetë, njësitet policore të angazhuara në këtë operacion kanë qëndruar në gjendje gatishmërie, në pritje për intervenim vetëm nëse situata e kërkon nevojën e ndërhyrjes së tyre. Gjatë gjithë kësaj kohe njësitet policore ishin kujdesur për mbarëvajtjen e rendit dhe nuk kishin pasur nevojë për ndonjë intervenim sa i përket përdorimit të forcës.

6.4 Pas shfaqjes së deputetit A. Kurti në protestë me datën 28.11.2015 Policia e Kosovës e obliguar për realizimin e urdhëresën me nr. PPRKR. nr. 413/15, lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës Themelore të Prishtinës, me datën 17.11.2015, kishte arritur që pas angazhimit të operacionit policor më NJSI të realizoj këtë urdhëresë. Ky operacion policor kishte ballafaquar njësitet policore me një turmë protestuesish të cilit kishin rezistuar dhe ishin përpjekur të pengojnë avancimin e njërive policore drejtë selisë së VV-së me ç' rast për të neutralizuar këtë rezistencë NJSO kishte përdorur sprej OC dhe shufrat e gomës. Pas përdorimit të kësaj force, NJSO kishte arritur t'i krijoj parakushte NJSI-së që të hyjë brenda selisë së VV-së dhe të realizoj urdhëresën.

6.5 Policia e Kosovës posedon një infrastrukturë ligjore të mjaftueshme për realizimin e detyrave dhe autorizimeve të saj, duke filluar nga Ligji i Policisë, Udhëzimet Administrative, Procedurat Standarde të Operimit dhe udhëzues të ndryshëm. Udhëzimi Administrativ 02/2012, për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor dhe Procedura Standarde e Operimit NJSI/PSO/001/11, në çështjen e angazhimit të NJSI-se infrastruktura ligjore ishte në harmoni njëra me tjetrën sa i përket autoritetit për angazhimin e kësaj Njësie.

6.6 Urdhrat Operativ të DPP, Planet Operative të Departamentit të Hetimeve, Divizionit të Njësive të Specializuara dhe Drejtorisë Rajonale Policore Prishtinë, në elementet pesë pikësh të modelit për hartimin e urdhrave/ planeve operative, konkretisht tek Administrimi dhe Komunikimi nuk kanë potencuar shënimet relevante që janë të parapara në udhëzuesin për hartimin e urdhrave dhe planeve operative dhe menaxhimin e operacioneve policore, si dhe ka pasur raste kur disa nga çështjet ju është ndërruar reditja duke mos u shënuar në pikën konkrete por është potencuar në ndonjërin nga pikat tjera të urdhrit/planeve operative.

6.7 Realizimi i Urdhër Arrestit PPRKR .nr. 413/15, është bërë në përputhshmëri me nenin 110, paragrafi 1, pika 1.5, të KPPK-së. Mirëpo, Policia e Kosovës pas realizimit të urdhër arrestit ka bërë kontrollimin e objektit të Lëvizjes Vetëvendosje nën dyshime për gjësede të kundërligjshme. Pas përfundimit të këtij kontrolli, PK-ja i ka dorëzuar raportin lidhur me kontrollin prokurorit kompetent, deri sa nuk ju është dorëzuar raporti me shkrim Gjyqtarit të Procedurës Paraprake në mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit, në pajtim me dispozitat e paraparë në nenin 110, paragrafi 6, i KPPK-së.

6.8 Gjatë protestës së 28 nëntorit 2015, tek selia e VV-së, një numër i aktivistesh protestues të dhunshëm ishin përpjekur të pengojnë njësitet policore të operojnë në detyrat policore. Si rezultat i një rezistence aktive, PK kishin përdorur: forcë fizike, shufrat e gomës/mburojat dhe sprej (OC). Në këtë intervenim dhe ballafaqim direkt me njësitet policore ka pasur disa persona të lënduar si rezultat i rezistencës dhe ballafaqimit direkt me njësitet policore. Po ashtu nga ana e njësiteve policore janë arrestuar 97 persona ndaj të cilëve janë përfillur procedurat e mëtejme ligjore kurse zyrtarët policore të cilit kanë përdorur cilën do lloj të forcës policore kanë përfillur rregullat që dalin nga UA Nr. 02/2012 Për Përdorimin e Forcës nga ana e Zyrtarëve Policor.

6.9 Udhëheqësit e Dhomës Komanduese kanë angazhuar NJSI, duke pasur në konsideratë ngjarjen e krijuar, numrin e protestuesve që kishin bllokuar hyrjen në selinë e lëvizjes VV, informatën për një numër të konsiderueshëm të personave që kishin qenë brenda objektit që duhej kryer operacioni, mungesën e informacioneve për individët që kishin qenë brenda në objekt si dhe trajnimet e njësive policore. NJSI, kishte arritur që në afat kohor për afërsisht prej 25 minutave të përfundonte operacionin dhe të tërhiqej nga vendi i ngjarjes duke lënë njësit tjera që të përfundojnë detyrat tjera. Kjo njësi speciale intervenuese referuar UA 02/2012, për Përdorimin e Forcës nga Zyrtarët Policor nënkupton njësitin e policisë për ndërhyrje i cili përbëhet nga zyrtarët policor të trajnuar dhe certifikuar të cilët janë të pajisur me mjete dhe uniforma të veçanta speciale për intervenim-ndërhyrje në rastet kur vlerësohet se rreziku është i nivelit tejet të lartë, për të cilën çështje PK-së në rregullativa ligjore nuk ka potencuar në mënyrë të qartë kuptimin e përkufizimit/domethënien e shprehjes lidhur me rrezikun e nivelit tejet të lartë.

6.10 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, DRP-Prishtinë, DH pranë DPP-së si dhe Njësitë e Specializuara të angazhuara në plan operativ, kanë përpiluar Raportet Pas Operacionale në të cilat specifikisht dhe në mënyrë kronologjike kanë përshkruar të dhënat dhe rrjedhën e mbarëvajtjes së ngjarjes si dhe menaxhimin e situatës nga ana e PK-së me datën 28 nëntor 2015. Gjatë inspektimit ekipi i IPK-së kishte kërkuar nga secili komandant taktik i angazhuar në operacionin policor të 28 nëntorit raportet pas operacionale, mirëpo një numër i tyre nuk kishin përpiluar fare raporte me arsyetimin së nëpër pikat ku ata kanë qenë në detyrë situata ka qenë e qetë dhe së fare nuk a kanë pasur ndonjë ballafaqim me protestues.

## 7. REKOMANDIMET

---

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor, IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

1. IPK- rekomandon Strukturën policore përgjegjëse në dhomat komanduese që gjatë ngjarjeve kritike dhe delikate të operacioneve policore, që zyrtaret kompetente për mbajtjen e shënimeve në logun e ngjarjeve të jenë me vigjilente dhe të kujdesen që të ketë përfshirje të mjaftueshme i të gjitha informatave të zhvilluara më mjetet zyrtare të komunikimit, si dhe PK-ja gjatë këtyre operacioneve të bëjë përpjekje maksimale të aplikoj komunikimin me radiolidhje përveç rasteve kur nuk mund të ketë alternativë tjetër.
2. IPK- rekomandon Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, të angazhoj ekip i cili do të azhurnojë dokumentet ligjore siç janë Udhëzimi Administrativ 02/2012 Për Përdorimin e Forcës nga ana e zyrtarëve Policor dhe Procedura Standarde e Operimit për NJSI, duke u siguruar që këto dokumente të jenë të harmonizuara në plotësi njëra me tjetrën.
3. IPK- rekomandon Drejtorisë për planifikim dhe Vlerësim Operacional, që gjatë përpilimit të Urdhrave/Planeve Operative të respektojnë në përpikëri të gjitha pikat e Udhëzuesit për Hartimin e Urdhrave & Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore.
4. IPK- rekomandon udhëheqësve të të gjitha niveleve hetimore, që gjatë angazhimeve dhe ndërmarrjes së veprimeve hetimore të jenë të kujdesshëm në kërkesat ligjore gjatë mbledhjes së provave në vend ngjarje.
5. IPK –rekomandon Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë, të angazhoj ekip i cili do të punojë në drejtim të përcaktimit të saktë të domethëniveve shprehimore për llojet e nivelit të rrezikshmërisë, të cilat do të precizoheshin në rregullativën ligjore.
6. IPK- rekomandon menaxhmentin policor të PK-së që në rastet e përfshirjes në operacione sipas urdhrave operativ dhe planeve operative secili zyrtare policor i cili është i caktuar në detyrat si komandant taktik pas përfundimit të operacionit të hartojë raporte pos operacional pavarësisht nevojës së intervenimit, ballafaqimit me turma protestuese apo nevojën e përdorimit të forcës.



## 8. PLANI I VEPRIMIT TË PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK-së

Nr	Rekomandimi	Komentet	Plani i veprimit
1	IPK- rekomandon Strukturën policore përgjegjëse në dhomat komanduese që gjatë ngjarjeve kritike dhe delikate të operacioneve policore, që zyrtaret kompetente për mbajtjen e shënimeve në logun e ngjarjeve të jenë me vigjilente dhe të kujdesen që të ketë përfshirje të mjaftueshme i të gjitha informatave të zhvilluara më mjetet zyrtare të komunikimit, si dhe PK-ja gjatë këtyre operacioneve të bëjë përpjekje maksimale të aplikoj komunikimin me radiolidhje përveç rasteve kur nuk mund të ketë alternativë tjetër.	Rekomandimi ne fjale do të Plotësohet/Zbatohet ne plotni gjatë Operacioneve Policore ne Vazhdim.	Do te kërkohet qe si Log Mbajtës të caktohet Personel me shkathtësi dhe aftësi te mira komunikuese ,te shkrimit dhe te njohjes se Procedurave ( edhe pse është përgjegjësi e Udhëheqësit te Dhomës Komanduese kontrollimi i te dhënave ne Log gjatë gjithë Kohës se Operacionit.
2	IPK- rekomandon Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, të angazhoj ekip i cili do të azhurnojë dokumentet ligjore siç janë Udhëzimi Administrativ 02/2012 Për Përdorimin e Forcës nga ana e zyrtarëve Policor dhe Procedura Standarde e Operimit për NJSI, duke u siguruar që këto dokumente të jenë të harmonizuara në plotësi njëra me tjetrën.	Drejtoria e Njësiave Speciale ka dorëzuar tek DAP-i propozimin për plotësimin e Udhëzimi Administrativ 02/2012 Për Përdorimin e Forcës në shkurt të Vitit 2016 dhe i njëjti është Aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm (Udhëzimi Administrativ 01/2016 mbi ndryshimin dhe plotësimin e nr.02/2012 për përdorimin e forcës nga zyrtarët policor)	Më datën 25 Gusht do të dorëzohet tek Drejtori i Departamentit të Operacioneve për Aprovim PSO-ja finale e NJSI-së e cila do të jetë në përputhje të plotë të pikave që i parashih për ndryshim dhe plotësim UA 01/2016
3	IPK- rekomandon Drejtorisë për planifikim dhe Vlerësim Operacional, që gjatë përpilimit të Urdhrave/Planeve Operative të respektojnë në përpikëri të gjitha pikat e Udhëzuesit për Hartimin e Urdhrave & Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore.	Lidhur me rekomandimin ne fjalë, DPVO ne vazhdimësi Respekton Pikat qe dalin nga Udhëzuesit për Hartimin e Urdhrave & Planeve Operative dhe Menaxhimin e Operacioneve Policore , duke e ditur se Hartimi i nje UO është proces i vazhdueshem, behet Perpjekje Maksimale per përfshirjen e te gjitha Elementeve kryesore ne te.	Ne te ardhmen do ti kushtohet kujdes i shtuar Hartimit te UO edhe pse është e paqart se per qfar shenimesh behet fjal ne rekomandimin tuaj citoj “ Inspektimi ka vënë në pah se disa nga shënimet në këto dokumente tek elementi pesë pikësh konkretisht tek Komunikimi dhe Administrimi ka pasur raste kur disa shënime nuk kanë qenë të plota ose shënimeve ju është ndërruar destinacione”.
4	IPK- rekomandon udhëheqësve të të gjitha niveleve hetimore, që gjatë angazhimeve dhe ndërmarrjes së veprimeve hetimore të jenë të kujdesshëm në kërkesat ligjore gjatë mbledhjes së provave në vend ngjarje.	Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë e shtetit e të mbështetur nga ekspertët ndërkombëtarë në kuadër të projektit të Binjakëzimit “ Fuqizimi i Kapaciteteve për Hetime Penale Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit ka draftuar një draft dokument Drafti dokumenti”Udhëzim i dizajnuar për	Do te kerkohet zbatim i udhezimeve nga doracak si dhe i dispozitave ligjore te Kodeve penale. Do te vazhdohet me trajnime ne kete fushe per zyrtaret policor.

		<p>Prokurorinë e shtetit dhe Policinë e Republikës së Kosovës” dhe ankesi shtese i këtij dokument janë “          Formularët e standardizuar” të cilët përdoren gjatë hetimit të rasteve Penale dhe me të cilin dokument synohet që të jepen udhëzime hetuesve të PK-së dhe Prokurorëve të Prokurorisë së shtetit për veprimet e tyre para dhe gjatë procesit të hetimeve, ku përfshihen edhe shikimin e vendgjarrjes.          Gjithashtu janë organizuar edhe trajnime për hetuesit policor dhe ekspertet e forenzikes.</p>	
5	<p>IPK-rekomandon Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë, të angazhojë ekip i cili do të punojë në drejtim të përcaktimit të saktë të domethëniesve shprehimore për llojet e nivelit të rrezikshmërisë, të cilat do të precizoheshin në rregullativën ligjore.</p>	<p>Për PK llojet e nivelit të rrezikshmërisë janë të përcaktuara me anekset J-16 &amp; J-17 përbrenda PSO Reagimi emergjent në fatkeqësi të ndryshme, DDO-04/023/2013, dt. 26.02.201, ku kemi dmth shprehimore kur kemi të bëjmë me menaxhimin e tubimeve publike</p>	<p>Do formohet ekipi për shqyrtimin e këtyre dmth konform mësimëve të nxjerra nga mënyrat e sjelljes së personave gjatë të gjitha llojeve të tubimeve publike e sidomos gjatë protestave.</p>
6	<p>IPK-rekomandon menaxhimin policor të PK-së që në rastet e përfshirjes në operacione sipas urdhrave operativ dhe planeve operative secili zyrtarë policor i cili është i caktuar në detyrat si komandant taktik pas përfundimit të operacionit të hartojë raporte pos operacionale paqarësisht nevojës së intervenimit, ballafaqimit me turma protestuese apo nevojën e përdorimit të forcës.</p>	<p>Secili Komandat Taktik pas çdo angazhimi operacionale e ka të paraparë me PSO që të raportojë pas operacionit ma shkrim për veprimet e ndërmarra dhe rrjedhën e operacionit. Komandanti Operacionale e dërgon pas çdo operacioni raportin pas operacionale tek Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim operacionale.</p>	